

Cross-border cooperation for sustainable development and tourism, through valorization of rural cultural heritage and conservation of natural asset of areas with ancient olive groves

Plani Ndër-Kufitar për Zhvillimin e SHPEJTË dhe të Qendrueshëm të Turizmit për Ullishtet e Vjetra në Shqipëri, Mal të Zi dhe Molise



Agricultural University
of Tirana - AUT



CIHEAM
BARI



Association for Sustainable
Regional Groves - Valdano



Municipality of Bar



Park Authority
of Venafro



Urban Research
Institute - URI

Autor: Gianfranco Ciola, Agronom

Drejtor i mëparshëm i Parkut Rajonal të Dunave Bregdetare (Apulia)

Bashkëpunëtorë: Gianfranco Cataldi, Roberta Callieris, Gianluigi Cardone – CIHEAM Bari

Përkthyes: M. Marini, A. Novielli, (CIHEAM Bari)

Coordinatorë P. Pasko dhe N. Dubla (CIHEAM Bari)

Falënderojmë:

B. Di Terlizzi dhe M. Semeraro për koordinimin e përgjithshëm të projektit (CIHEAM Bari)

F. Sallaku, E. Kullaj, I. Angoni, A. Lazaj, E. Demiraj, – Universiteti Bujqësor Tiranë - Shqipëri

J. Calabrese dhe P. Zdruli për kontributin e tyre në Biodiversitetin dhe Praktikën e Mira (CIHEAM Bari)

E. Kocani, I. Janushi, E. Vokopola – Instituti Kërkimeve Urbane, Shqipëri

E. Pesino, G. Cutillo, A. Rossi – Autoritete të Parkut të Venafrò, Molise, Itali

A. Zivanovic, M. Markoc. M. Knezevic – Bashkia Tivar, Mal i Zi

F. Cakuli, K. Hidrio, Xh. Cakuli – Shoqata për Kultivimin Rajonal të Qendrueshëm të Ullirit, Valdanos, Ulqin, Mal i Zi

Dhe të gjithë bashkëpunëtorët e terrenit që morën pjesë në këtë projekt dhe bënë të mundur prodhimin e këtij publikimi.

ISBN 978-2-85352-606-7

RENDITJA E LOGOVE – (EDHE NË BROSHURË)

AUT TIRANA, CIHEAM BARI, URI, VENAFRÒ, BAR, VALDANOS

PLANI NDËR-KUFITAR
PËR ZHVILLIMIN E SHPEJTË DHE TË QENDRUESHËM TË TURIZMIT

PËRMBAJTJA

HYRJE

- 1. Qëllimet e Planit**
- 2. Studimi i zonave të përfshira në projekt**
 - 2.1. "Sistemi i ullishteve të vjetra"
 - 2.2. Burimet e prekshme dhe jo të prekshme
 - 2.3. Mjedisi social-ekonomik i zonave të projektit
 - 2.4. Instrumentet e planifikimit të tokës në zonat rurale me ullishte
- 3. Potencialet dhe mangësitë e zonave të projektit**
 - 3.3. Mangësitë ekzistuese të zonave të kultivimit të ullirit
 - 3.4. Potencialet e zonave të kultivimit të ullirit
- 4. Harta e praktikave të mira për menaxhimin e qendrueshëm dhe përmirësimin e ullishteve të vjetra**
- 5. Hartat komunitare të ullishteve monumentale**
- 6. Harta e aktorëve të përfshirë**
- 7. Strategjia e Planit për zhvillimin e qendrueshëm të turizmit**
- 8. Plan i Veprimit për ullishtet e vjetra**
 - 8.1. Marrdhënia e ullishteve të vjetra me sistemin natyror dhe menaxhimi i qendrueshëm i tyre
 - 8.2. Përdorimi i qendrueshëm i ullishteve dhe krijimi i një produkti të ri turizmi
 - 8.3. Trajnimi i operatorëve, zhvillimi profesional dhe mjedisor dhe edukimi për ushqimin
 - 8.4. Promovimi i zonës, produkteve dhe shërbimeve të turizmit
- 9. Konkluzione**

HYRJE

Një *Turizëm i përbashkët dhe i qendrueshëm* për të dy brigjet e detit Adriatik, që lidhin Italinë, Shqipërinë dhe Malin e Zi, është një aspiratë e dëshiruar gjatë nga komunitetet bregdetare, një ambicje e kohëve të fundit e operatorëve turistikë dhe një zbulim i ri për turistët lokalë dhe ndërkombëtarë. Kjo ëndërr mund të bëhet realitet nëse ullahtet e vjetra do të vlerësohen siç duhet: ato janë monumente të gjalla dhe të lashta të gërshetimit të disa qytetërimeve.

Projekti Ndër-Kufitar i Ullirit ka identifikuar një Plan të Përbashkët Ndërkufitar që përshkruan masat përkatëse për promovimin e turizmit të qendrueshëm, kombinimit të traditave, tipikaliteteve dhe dëshmive të natyrës. Ky është rasti i mijra hektarëve të ullahteve të vjetra të shpërndara në zona të ndryshme që zbulojnë gjithë bukurinë e relievit të tyre: Venafrò në Itali, Ndroq, Marikaj dhe Prezë në Shqipëri, Dzidzarin në Tivar dhe Valdanos në Ulqin në Mal të Zi.

Megjithëse të ndara vetëm nga pak qindra kilometra det, zonat e projektit shfaqin cilësi të jashtëzakonshme individuale sa i takon biodiversitetit, relievit me bukuri unike, historisë, kulturës, dhe traditës kulinare, përsëri ato ndajnë të njëjtën pasuri: ullahtet e tyre shekullore.

Plani Ndër-Kufitar i Zhvillimit paraqet një pikë referimi, duke qenë se është rezultat i një studimi të thellë dhe shumë aktiviteteve në terren. Janë kryer disa aktivitete në bashkëpunim të ngushtë dhe me shkëmbime njohurish të ekspertëve të të tre vendeve, për të marrë një fotografi të statusit të biodiversitetit, identifikuar grupet e interesit, intervistuar operatorët për përcaktimin e praktikave më të mira të kultivimit për menaxhimin e ullahteve shekullore, dhe për të krijuar hartën e trashëgimisë historike, kulturore dhe kulinare të çdo zone. Ky dokument, nisur nga një propozim ambicioz, shënon gjithashtu një fillim të ri, që tashmë përkthehet në Planet e Zhvillimit Lokal Mjedisor dhe Ekonomik, dhe Hartat Lokale Mjedisore, të Burimeve Kulturore dhe Komuniteteve. Qasja bashkëpunuese ka qenë edhe forca udhëheqëse për projektin dhe personat që kanë kontribuar me aftësitë dhe njohuritë e tyre në zbatimin e tij: studjuesit, operatorët e sektorit të ullirit, operatorët turistikë, përfaqësuesit e institucioneve kombëtare dhe lokale dhe, më në fund, banorët e komuniteteve të përfshira në të dyja brigjet e detit.

Fatkeqësisht, situata aktuale e pandemisë ka kufizuar transferimin e njohurive në fazën e dytë të projektit, e cila do të ishte lehtësuar shumë nëpërmjet prezencës personale, misioneve në vend dhe udhëtimeve të partnerëve për shkëmbim eksperience.

Puna e kryer në projektin INTERREG CROSS BORDER OL ka pasur si qëllim krijimin e urave imagjinare përmes detit Adriatik, për të lidhur popujt, etnitë, dhe kulturat nën syrin e paqtë të ullahteve shekullore dhe të inkurajojë shkëmbimet ndërkombëtare dhe turizmin.

Maurizio Raeli

Drejtor

CIHEAM Bari

Fatbardh Sallaku

Rektor

Universiteti Bujqësor Tiranë

1. Qëllimet e Planit

WPT2 është i fundit Plan Pune që promovon turizmin e qendrueshëm dhe natyral dhe trashëgiminë kulturore, nëpërmjet një procesi pjesëmarrës, që përfshin si partnerët publikë edhe ata privatë, me synimin për bashkë-zhvillim dhe shkëmbim të një Plani Ndër-Kufitar të Zhvillimit të Shpejtë dhe të Qendrueshëm të Turizmit ndërmjet partnerëve, që do të zbatohet përtej kufijve të zonave target në Shqipëri, Mal të Zi dhe Molise.

Në mënyrë më specifike, Plani i Punës përmban iniciativa kolektive që synojnë rritjen e ndërgjegjësimit të partnerëve dhe veçanërisht të qeverive/administratave vendore dhe qendrore, mbi asetet natyrore dhe mjedisore, planet vendore të zhvillimit dhe ndërtimit të kapaciteteve. Rezultati është plani ndër-kufitar, i cili është një model i ri për promovimin e përbashkët të trashëgimisë në të gjithë rrjetin. Ai përmban si masat ekonomike për zhvillim të qendrueshëm edhe një planifikim të integruar që ka për qëllim promovimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore. Kjo arrihet nëpërmjet instrumenteve lokale (harta dhe plane) për mbrojtjen e mjedisit dhe turizmin e qendrueshëm. Të gjithë partnerët e projektit (PP) janë përfshirë në përcaktimin e hartave dhe planeve vendore me qëllim bashkëplanifikimin për një turizëm ndër-kufitar të shpejtë dhe të qendrueshëm.

CIHEAM IAMB është lideri i Planit të Punës, bazuar në eksperiencën e tij të mëparshme për dizenjimin e planeve të zhvillimit rural dhe ekonomik dhe transferimit të njohurive dhe praktikave të mira me qasje nga poshtë-lart.

Plani Ndër-Kufitar për Zhvillimin e Shpejtë dhe të Qendrueshëm të Turizmit:

- Integron në nivel ndër-kufitar itineraret tematike që janë zbatuar në aktivitetet e mëparshme të vendeve, përfshi burimet mjedisore dhe kulturore dhe hartat e komuniteteve (CIHEAM IAMB do të marrë përgjegjësinë e mbështetjes dhe sigurimit të instrumenteve për integrimin e rezultateve të aktiviteteve të mëparshme)
- Është një plan mjedisor, ekonomik dhe turistik që sjell së bashku rezultatet e arritura nga planet vendore të zhvillimit
- Të gjithë partnerët kontribuojnë në proces duke identifikuar dhe ju dhënë përparësi burimeve dhe aseteve karakteristike të territoreve të tyre që rezultojnë në hartimin e Planeve të Zhvillimit Vendor Ekonomik Mjedor dhe Turistik
- Është një model i ri për promovimin e përbashkët të trashëgimisë në rrjet, nëpërmjet ndjekjes së rrugëve për zhvillim të përshtatshëm
- Është një mjet që i intereson zonës së bashkëpunimit për përmirësimin e efektivitetit të politikave dhe instrumenteve ndër-kufitare
- Është një plan veprimi i përbashkët për menaxhim të qendrueshëm të destinacioneve turistike që mund të adoptohet nga autoritetet publike në zonat target
- Është një instrument efektiv për promovimin e përkushtimit të palëve të interesuara për të shtuar bukurinë e pasurisë natyrore si pjesë e turizmit të qendrueshëm
- Është i zbatueshëm dhe i replikueshëm në zona ose rajone të tjera për të përmirësuar aktivitetet rurale të lidhura me turizmin, duke marrë në konsideratë transferimin e rezultateve të Planeve të Zhvillimit Vendor, Mjedor, Turistik dhe Ekonomik.

2. Studimi i zonave të përfshira në projekt

2.1. “Sistemi i ullishteve të vjetra”

Në Shqipëri janë përzgjedhur tre zona të ullishteve të vjetra në rajonin në Tiranë, Ndroq në Bashkinë Tiranë dhe Prezë dhe Marikaj në Bashkinë Vorë. Shqipëria ka një trashëgimi totale prej mbi 1.7 milion pemë ulliri shekullore, pjesa më e madhe e të cilave ndodhen përreth Tiranës dhe Vorës, por gjithashtu në Durrës, Mallakastër, Elbasan, Lezhë dhe Shkodër.

Ullinjtë ekzistues në tre zonat e përzgjedhura janë përfaqësues të ullishteve të vjetra të vendit; ato i përkasin së ashtuquajturës “Kurora e Tiranës” që përfshin një sërë kodrash me lartësi më të vogël se 400 m mbi nivelin e detit (asl) dhe të mbuluara me vegjetacion miks, përfshi shkurret, dhe ullishte shekullore me një pasuri të madhe flore dhe faune që i bën këto zona shumë tërheqëse për turistët. Për shekuj me rradhë këto forma të biodiversitetit natyral dhe bujqësor kanë jetuar gjatë duke arritur një balancë të qëndrueshme ekologjike ndonëse shumë herë të shqetësuar nga veprimet ndërhyrëse të njeriut, megjithatë menaxhimi aktual i këtyre ullishteve mund të klasifikohet me nivel të ulët impakti në mjedis.

Të tre zonat e përzgjedhura janë të ngjashme sa i takon praktikave bujqësore tradicionale. 100% e veprimeve në fermë kryhen me dorë, duke rezultuar në kosto të larta.

Shumica e ullishteve gjenden në zona kodrinore dhe malore, duke shkaktuar vështirësi për vjeljen dhe punimet e tokës në kohën e duhur. Një pjesë e fermerëve kanë zgjedhur të mbajnë punimet e tokës në minimum, ndërsa për më shumë se 50% të ullishteve nuk praktikohet punimi i tokës. Ullishtet tradicionale dhe marginale bazohen në ndërhyrje rastësore, me krasitje që kryhet çdo 10 vjet për të hequr të gjithë kurorën. Kjo krasitje drastike dhe jo racionale kompromenton vlerat estetike dhe monumentale të ekzemplarëve të pemëve të mëdha të ullirit.

Menaxhimi i tokës në ullishtet e pjerrta sigurohet nëpërmjet vetulloreve të ndërtuara me gurë të thatë ose plisa dheu në anën e poshtme të shpatit për krijimin e tarracave të vogla që kontribuojnë në balancimin e faktorëve hidrologjikë, termalë, dhe mikroklimatikë të tokës, përmirësojnë relievin, bëhen strehë për shumë insekte të dobishëm që ndihmojnë në ruajtjen e biodiversitetit dhe të balancës natyrale të agro-ekosistemit. Një mënyrë tjetër natyrale për të siguruar të njëjtin funksion është vendosja e rreshtave të pemëve ose pemëve perpendikular me linjën e pjerrësisë.

Ullishtet në lartësi të mëdha ose të vështira për tu mbërritur për arsye të pjerrësisë ose mungesës së rrugëve janë braktisur, dhe rezultojnë me rrezik të lartë ndaj zjarreve. Një pjesë e madhe e ullishteve nuk është e aksesueshme nga infrastruktura rurale.

Vjelja e vonuar e ullinjve dhe praktika e ruajtjes së ullinjve të vjelë në qese është shkaku kryesor i humbjeve të prodhimit dhe prishjes së cilësisë së vajit të ullirit.

Kultivari kryesor, *Ulliri i Bardhë* shoqërohet me *Olivaster*, *Ulliri i Zi*, *Ulliri i Kuq* dhe, në Prezë, madje edhe me *Kushan*. *Olivaster* i Kuq i Tiranës gjendet pothuaj në të gjitha ullishtet shekullore ekzistuese në Tiranë dhe Durrës.

Ndroq është një nga 15 Njësitë Administrative të Tiranës, me një popullsi prej rreth 9,356 banorë. Fshati i vjetër, vendosur mbi ullishtet lidhet me rrugën Tiranë - Durrës – Kavajë. Prej Kalasë në kodër shihet krejt fusha.

Në zonën e Ndroqit, ka 795 hektarë ullishte, prej të cilave, 682 ha ullishte shekullore të vendosura në shpatet e kodrave të Ndroqit, në jug të lumit Erzen. Rreth 191 ha janë vendosur në kodra me 15 dhe 20% pjerrësi, ku 543 ha kanë një pjerrësi më të madhe se 25%; 28% e hektarëve ndodhet në kodra me tarraca.

Prej 25,000 ullinjsh shekullorë, mbi 200 janë shumë të lashtë dhe gjenden në Kërçukje, Sauqet, Grëbllesh dhe Varrosh. Kjo zonë është një nga dëshmitë më të lashta të kultivimit të ullinjve. Disa pemë monumentale ulliri ndodhen pranë kalasë në Varrosh, muret e së cilës u ngritën gjatë invazioneve barbare të shekujve IV-VI.

Në Ndroq ka mullinj të vjetër guri që provojnë prodhimin shumë të hershëm të vajit të ullirit si edhe 8 fabrika moderne.

Preza i përket bashkisë Vorë dhe ndodhet në mes të rrugës Tiranë-Durrës. Daton rreth 2,000 vjet më parë, kur është ndërtuar edhe kalaja. Ullishtet shekullore zënë rreth 17 hektarë në këmbë të kodrave të zonës Prezë, me densitet 120 rrënjë për hektar. Midis tyre ka 8 ha plantacione ulliri përreth kalasë në toka shumë të pjerrta, ndonjëherë në tarraca. Kjo është një ullishte shumë e vjetër me mbi 1,000 pemë ulliri me vlerë të pakrahasueshme panoramike. Pjesa më e madhe e pemëve është 400-500 vjeçare. Shumë pemë nuk marrin kujdesin e duhur për kultivim.

Në këtë zonë nuk ka fabrika vaji, por vajin përdoret fabrika e Marikajt.

Marikaj i përket bashkisë Vorë. Ullishtet e vjetra ndodhen në kodrat e fshatit Marikaj që ka një traditë të gjatë në prodhimin e vajit të ullirit. Sipërfaqja e përgjithshme e mbjellë me ullinj është 806 ha, prej të cilëve 155 ha me ullishte shekullore (86 ha vetëm në Marikaj). Ato janë mbjellë në toka me pjerrësi që kalon 15% dhe me densitet mesatar 80 rrënjë për hektarë.

Vaji i prodhuar në Marikaj është eksportuar nga shekulli XVII deri XVIII në Republikën e Venecias dhe në kryeqytetin e Perandorisë Otomane.

Relievi përreth Venafros karakterizohet nga prania e ullishteve që zënë një sipërfaqe totale prej 457 hektarësh. Pjesa më e madhe e ullishteve bie brenda Parkut Rajonal të Ullirit në Venafrë që shtrihet në anën jugore të Santa Croce ose Malit Cerino dhe Malit Corno.

Zona e mbjellë me ullinj është në lartësinë 500 m dhe shtrihet mbi tarraca me mirëmbajtje të niveleve të ndryshme. Struktura e mbjelljeve ndjek kryesisht linjat e relievit; në disa raste në zonat më të ulta është adoptuar modeli *quincunx* (në formë drejtkëndëshi me katër pemë në anët e tij dhe një pemë në qendër).

Disa ullishte shekullore ende tregojnë shenja të memories historike të teknikave të kultivimit të përdorura në Mesdhe, të tilla si grumbullimi i gurëve poshtë pemës që ndihmon rregullimin e temperaturës për sistemin rrënjor, dhe muret me gurë të thatë që shërbenin për të njëjtin funksion, madje më të amplifikuar, pasi ato bëjnë të mundur drenazhimin optimal të tokës.

Gjithashtu ka kultivarë unikë, të tilla si *Aurina*, një varietet nativ i Venafrasë, i cili mund të shoqërohet me "Licinia" varietet i kohës Romane; *Olivastro dritto*, shumë i përhapur në ullishtet në Venafrë; *Olivastro breve* me lulëzim kompakt dhe për kohë të shkurtër; *Rossuola*, që lidh frute të cilët mbetën në gjyrë të kuqe deri në kohën e pjekjes; *Gnagnaro*, i cili ka frutin më të vogël nga të gjitha varietetet kultivuara të ullirit, si edhe duhet konsideruar kultivari *Oleaster* i Romanëve; *Sperone di Gallo* që bën frute që të kujtojnë në formë dhe madhësi lafshën e gjelit.

Në vitin 1936, Gennaro Nola, një agronom i lindur në Venafrë (*L'Olivicoltura in Agro di Venafrë e le varietà coltivate* - 1936 – Roma) identifikoi tiparet morfologjike të varieteteve lokale të cilët rezultojnë të jenë 15, emërtuar si: 1) *Aurina* ose *Licina*, 2) *Pallante* ose *Pallone* ose *Luceгна*, 3) *Olivastro breve* ose *Olivastro d'Aprile*, 4) *Olivastro dritto* ose *cacacciaro*, 5) *Rotondella*, 6) *Rossuola* ose *Resciola*, 7) *Olivastrello*, 8) *Olivo maschio*, 9) *Gnagnaro*, 10) *Lagrimella*, 11) *Coglioni di gallo*, 12) *Ghiandara* ose *Circelluta*, 13) *Oliva spagnuola*, 14) *Olivo Gaetano*, 15) *Trignola*.

Prania e shumë varieteteve në ullishte justifikohet me tolerancën e tyre të madhe ndaj motit, duke siguruar prodhim të vazhdueshëm sipas frutifikimit vjetor të çdo kultivari.

Fragmentimi i tokës është ende karakteristik në zonën e ullishteve në Venafro. Kultivimi i ullirit ende bazohet në metoda tradicionale që shpesh janë indiferente ndaj praktikave racionale bujqësore. Teknikat kultivuese të aplikuara konsistojnë më së shumti, veçanërisht për ullishtet familjare, në kositjen e bimëve barishtore dhe krasitjen. Krasitja bëhet me dorë, çdo 2 vjet, në Prill. Në kushte ndriçimi të mirë, pemët krasiten në formë kupe duke lënë 3-4 degë të mëdha me degëzim dikotomik. Në shumë raste, është e nevojshme krasitja e rëndë për uljen e kurorës për të kundërvepruar ndaj rritjes së menjëhershme të kultivarit *Aurina*.

Kultivimi historik i ullirit në Venafro i është dedikuar kultivimit marginal të ullirit dhe për këtë arsye është degraduar dhe abandonuar progresivisht në dekadat e fundit. Autoritetet e Parkut promovojnë përhapjen e kultivarëve të vjetër të ullirit, përfshi kultivarin *Aurina*, të cilat janë esenciale për diversitetin biologjik agro-mjedisor, dhe synojnë të orientojnë kullotjen, duke favorizuar kullotën e dhenve si mjet natyral për mirëmbajtjen e ullishteve.

Në zonën e Venafrosë ka tre mullinj kryesorë vaji, aktiviteti tregtar i të cilëve i lë pak hapësirë mjedisit të konsiderueshëm historik të zonës. Në kundërshtim me këtë, nën shtytjen e Parkut, janë krijuar ferma të reja brenda territorit të tij që janë përkushtuar dhe kanë si mision të tyre kombinimin e historisë me cilësinë.

Në Mal të Zi zonat e analizuar janë vetëm Džidžarin dhe Ulqin.

Džidžarin është një ullishte shekullore me mbi 10,000 pemë të moshës 200-500 vjeç dhe disa pemë mijëvjeçare, ndër më të mëdhatë dhe më të bukurat ekzemplare në Tivar. *Žutica* është varieteti më i përhapur (98%).

Në distancë 800 m nga Džidžarin, gjendet pema e ullirit në Mirovica, e cila është nga pemët më të vjetra të ullirit në botë, e mbrojtur me ligj kombëtar që prej vitit 1957. Instituti e Pyjeve dhe Bujqësisë në Stamboll e ka vlerësuar moshën e saj si 2,245 vjeçare.

Dabanovo dhe Marijala kanë ullishtet më të mëdha në Mal të Zi me mbi 50,000 rrënjë të moshës 200, 300 dhe 500 vjeçare, të vendosura menjëherë pranë zonës urbane.

Tivari njihet prej shekujsh për ullirin dhe prodhimin e vajit, i cili ka filluar të bjerë në vitet '70 dhe '80, me braktisjen e ullishteve në Džidžarin, të cilat ishin më të vështira për tu kultivuar. Aktualisht këto ullishte kanë nevojë për krasitje rigjenerative me qëllim që të zvogëlohet lartësia e pemëve nga 7-10 ose edhe 15 metra.

Ulliri është kultura kryesore, por fragmentimi i tokës, numri i vogël i pemëve në ullishtet dhe gjendja e tyre shëndetësore, si edhe numri i madh i pronarëve të tokës janë faktorë frenues të prodhimit.

Ka rreth 350-400 fermerë ulliri që kanë në pronësi 50-100 rrënjë ulli dhe madje edhe më shumë, dhe dy shoqata të ullirit në Džidžarin, Shoqata e kultivuesve të ullirit Tivar, e formuar në vitin 2002 dhe Shoqata e kultivuesve të ullirit Antivari, krijuar në vitin 2020, me 150 anëtarë kultivues ulliri. Objektivi i shoqatave është rritja e vlerës së kultivimit të ullirit duke mbështetur anëtarët për të rinovuar ullishtet e braktisura dhe ato të vjetra, krijimin e plantacioneve të reja, përhapjen e teknikave të kultivimit që synojnë përmirësimin e cilësisë. Ka 6 mullinj, 2 prej të cilëve në afërsi të Džidžarin.

Ullishtet e vjetra të kultivuara prej 2,000 vjetësh në qytetin e **Ulqinit** përfaqësojnë historinë e qytetit. Kultivimi i ullirit dhe prodhimi i vajit të ullirit në **Ulqin** përbën një pjesë të pandashme të kulturës së vendit.

Ulqini shtrihet në brigjet e Adriatikut dhe është një port i vjetër; ai vlerësohet për vendet e tij historike, kulturore dhe natyrore. Plantacionet e ullirit zenë 3,200 hektarë, pranë brigjeve të detit ku varieteti dominant është *Žutica* me 95-98%. Varietete të tjera janë *Crnica*, *Lumbardeška*, *Sitnica*, *Šarulja* etj. Varietete të huaja, të tilla si *Picholine*, *Leccino*, *Coratina*, *Itrana*, *Ascolana tenera* numërojnë 3% të totalit.

Bashkia Ulqin strehon 80,000 pemë ulliri, prej të cilave 18,000 – përfshi edhe shumë prej tyre që janë mbi 1,000 vjeçare – gjenden në Gjirin Valdanos, i deklaruar si monument në vitin 1968. Në kuadrin e projektit ndërkufitar janë çertifikuar 92 pemë ulliri.

Pjesa më e madhe e ullishteve janë braktisur (rreth 30%) për arsye të emigrimit ose mosmarrëveshjeve ligjore mbi pronësinë, duke qenë se ato u riblenë nga qeveria 40 vite më parë, si në rastin e Gjirit të Valdanos.

Frekuenca e krasitjeve në Ulqin varion nga 2-5 vjet (29%), ndërsa në 41% të rasteve kryhet rregullisht çdo 1-2 vjet, por mbeturinat e krasitjeve lihen në sipërfaqe dhe janë rrezik për zjarret.

2.2. Burimet e prekshme dhe jo të prekshme

Për arsye të pozicionit të saj strategjik në Mesdhe, **Shqipëria** ofron një varietet të madh zonash ekologjike të gjeneruara nga konvergjenca e Mesdheut dhe klimës kontinentale, izolimi dhe mbrojtja që sigurohet nga prania e maleve, kontrastet topografike dhe një sërë luginash e lumenjsh që përshkojnë rajonin.

Shumë ullishte të vjetra, të menaxhuara duke përdorur praktikat tradicionale dhe të rrethuara me një rrjet të dendur muresh me gurë të thatë dhe shkurre Mesdhetare, përbëjnë habitate gjysmë-natyrore që luajnë një rol të rëndësishëm ekologjik për sigurimin e një niveli të lartë biodiversiteti të specieve të florës dhe faunës.

Vëzhgimi i përbërjes floristike të të treja zonave në studim është i dobishëm për të karakterizuar agro-ekosistemet e ullishteve monumentale në lidhje me nivelin e biodiversitetit të vegjetacionit të egër.

Në të treja zonat, janë identifikuar 45 specie që i përkasin 26 familjeve. Prej tyre në të treja ullishtet e përfshira në studim janë gjetur 7 specie të reja.

Speciet Mesdhetare dhe Euro-Mesdhetare përbëjnë 53%, ndërsa 87% përfshijnë bimësi medicinale dhe të ngrënshme ose bimësi që janë si medicinale edhe të ngrënshme. Dy prej specieve të vëzhguara *Arbutus unedo* L. dhe *Quercus ilex* L., përdoren në traditën e vendit për punime artizanale.

Përveç specieve që ndodhen brenda ullishteve, gjendet edhe një gamë e gjerë specimesh tipike shumëvjeçare të rajonit.

Ky nivel i lartë biodiversiteti është ruajtur gjatë viteve në saxe të mungesës së përdorimit të trajtimeve kimike në ullishte. Një eksperiencë domethënëse për kontrollin natyral të mizës së ullirit është kullotja e gjelave të detit në ullishte e cila ndihmon në eliminimin e pupave dhe larvave të insekteve në tokë, duke zvogëluar kështu popullatën e mizës së ullirit dhe infeksionet e mundshme nga gjeneratat e ardhshme.

Pyjet përfshijnë zona të tëra të mbuluara me pisha, gështenja, ah dhe shkozë. Zona me formacione bredhi karakterizohet nga shoqërimi me lis, dëllinjë, frashër etj. Zona me lisa ka pemë të tjera si mollë të egra, shkozë, frashër, dëllinjë etj.

Në kontekstin e zhvillimit të qendrueshëm, vendi konsiderohet të ketë kapacitet biopotencial, të karakterizuar nga specie të florës dhe faunës, pyje dhe mbi të gjitha ullishte tipike, të cilat ofrojnë një burim të ardhurash për banorët; ujëmbledhës; lumin Ishëm dhe fushat bujqësore Ahmetaq dhe Fushë-Prezë.

Zona e **Prezës** ofron një trashëgimi historike dhe kulturore që konsiston në kalanë e shekullit XV, të vendosur në kodrën e Prezës. Arkitektura tipike përqendrohet në vendbanime rurale në kodrat, ndërsa katundet përfitojnë nga një marrdhënie shumë e afërt me zonën përreth, që ofron relieve të këndshme. Arkitektura e shtëpive të vjetra paraqitet në stilin e kullave, ku ka dritare me harqe dhe grila druri në të katër anët e shtëpisë.

Në fshat ka ofrues privatë shërbimesh, përfshi 3 dyqane me mallra konsumi, 3 restorante, 5 kafe. Qyteza e Prezës, ndonëse e njohur për disa atraksione turistike, nuk ofron shërbime për vizitorët, të tilla si bujtina dhe hotele, pika informacioni, guida dhe paketa vizitash turistike, ATM dhe pika të shkëmbimit të parave.

Në zonën e **Ndroqit** ka shumë burime natyrore në një rreze të vogël sipërfaqeje, si p.sh. lumi Erzen që rrjedh përgjatë fshatit, burimet ujore dhe bukuria piktoreske e biodiversitetit natyral të terrenit kodrinor, që ofron mundësi për zhvillimin lokal të turizmit të qendrueshëm.

Fshati i vjetër Ndroq është një zonë e populluar dendur me ullishte, Kalaja e Varroshit, ndërtuar në shekullin IV (387 m mbi nivelin e detit) qendron mbi kodër dhe dominon fshatin. Atraksione të tjera përfshijnë një pemë ulliri 4000 vjeçare që gjendet në mes të fshatit Ndroq dhe “Varri i Ashikut” i vendosur pranë autostradës Tiranë-Durrës-Kavajë.

Venafro është streha e shumë vendeve me interes historik dhe kulturor për turizmin. Kështjella (Pandone Castle National Museum) origjinon nga fortesa megalitike e modifikuar gjatë shekujve dhe e transformuar më në fund në një rezidencë të Rilindjes në shekullin XIV. Sot, ajo është Galeia Kombëtare e Artit.

Muzeu Arkeologjik në Venafro është krijuar në manastirin Santa Chiara të shekullit të tetëmbëdhjetë. Duhet përmendur “Venusi i Venafros”, që daton në epokën Antonine (shekulli II pas Krishtit). Po aq të rëndësishëm janë edhe ujësjellësi Roman Augustan dhe “Chess of Venafro”.

Annunziata ose Kisha e Anunciatës në Venafro është një nga kishat më të bukura të Molises, ndërtuar në vitin 1386 nga Besëlidhja *Annunziata*.

Katedralja e Venafros, ndërtuar në shekullin XI në një tempull Kristian ekzistues, ka privilegjin të ketë Derën e Shenjtë që prej vitit 1508, dy shekuj pas Jubileut të parë.

Në rrugën *Via De Utris*, në pallatin homonim në qendrën historike dedikuar për evente historike, i cili në kohën e vijës mbrojtëse gjermane u pushtua nga trupat aleate në dimrin e vitit 1943; ndodhet një muze i rëndësishëm.

Shumë atraktive është vila rustike e ngritur në rrethinat pranë Pozzilli që disa studjues ia atribuojnë stinës bujqësore të verës të *Marco Porcio Catone*.

Parku, gjithashtu ka shumë atraksione turistike. Ai strehon rrënoja nga epoka Samnite dhe Romane: teatri Roman dhe Amfiteatri të ndërtuara në zonën e Venafros; mbeturina të shumë vilave rustike dhe hauzeve, në veçanti në *Madonna della Libera*, gjurmët e dukshme të një vile Romane që daton në epokën Sulla me tarraca të ndërtuara me një strukturë poligonale, me një haur çimentoje.

Një vendndodhje tjetër me interes është spoti paleontologjik i Torës dhe Picillit, jo larg Venafros, ku mund të shihen gjurmë të lashta këmbësh njeriu skalitur në rrjedhën e llavës, që datojnë rreth 400,000 vjet më parë.

Ndër atraksionet e parkut një vëmendje e veçantë i kushtohet kopshtit Italian të pemëve historike të ullirit, “Green Patriarchs” (Patriarkët e Gjelbër). Kjo hapësirë përmban 20 pemë ulliri mijëvjeçare Italiane, një për çdo rajon, të riprodhuara me fidanë të pemëve origjinale. Kopshti paraqet një vend ku duhet ndaluar patjetër për të gjithë turistët që vizitojnë Parkun dhe përbën bankën gjenetike Italiane për pemët mijëvjeçare.

Territori i Parkut të Venafros është i pasur në burime ujore, duke qenë se ndodhet në kryqëzimin e dy lumenjve, Volturno dhe San Bartolomeo (burimi i të cilëve është në qytetin e vjetër të Venafros). Ai dallohet nga një rrjet shtigjesh të vjetra mushke, mure Samnite dhe Romane dhe rrënojat e vilave rustike, përfshi shumë rezervuarë të shpërndarë në të gjithë territorin.

3 Km nga Venafro është ligatina *Le Mortine*, që karakterizohet me pyje ekstensive, që përshkohen nga lumi Volturno që formon ishuj të harlisur lumorë, të cilat janë habitate për specie të ndryshme çafkash dhe shumë shpendë uji (pata, rosa, mjellma). Gjithashtu ka edhe shumë kafshë të listës së kuqe të Unionit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN) për speciet e rrezikuara, të tilla si vidrat dhe breshkat.

Ligatina ndodhet në kufi me ish Rezervatin Mbretëror të Gjuetisë në Torcino, i famshëm për pyjet e pafund që vizitoheshin shpesh nga familja mbretërore e Burbonëve.

Përtej Malit Sammucro, 8 km nga Venafro, ndodhet Parku Memorial i San Pietros i aksesueshëm nga vizitorët. Më në fund edhe fshati magjepsës pas Venafros.

20 km larg Venafros, pylli me qiparisa Fontegreca përfaqëson një biotip të rrallë spontan që mbulon një sipërfaqe prej 70 hektarësh, të cilët ekzistojnë në këtë zonë që prej vitit 1500. Ai përfaqëson një nga pyjet e qiparisit spontan me interes të madh në rajonin e Mesdheut.

Parku Rajonal Roccamonfina është një zonë vullkanike me pyje të harlisur gështenje, plot me pemë shekullore. Flora e bollshme në ullishtet e Venafros përmban 302 specie të identifikuar nga projekti Interreg Project CBO. Zona ka një biodiversitet të madh dhe lista pritet të rritet nga viti në vit, pasi zbulohen specie të reja. Vlera mjedisore e Parkut rritet edhe më shumë nga prania e *Himantoglossum adriaticum* H. Baumann, hardhuca ngjyrë purpurt e Adriatikut, e renditur në listën e kuqe të IUCN.

Përbri brezit të kultivuar me ullinj dhe pjesërisht e përfshirë në të, ndodhet një zonë me rëndësi për komunitetin “Monte Corno Sammucro” (ITIT7212171) që përfshin një sipërfaqe të përgjithshme prej 1356 hektarësh që shtrihen ndërmjet 610 dhe 1205 m mbi nivelin e detit.

Në Mal të Zi, ullishtja e Džidžarin, që ndodhet jo larg qytetit historik të Tivarit, mund të eksplorohej me këmbë duke përshkuar shtigje ku mund të gjeni dëshmi të rëndësishme historike dhe kulturore (ura e vjetër prej guri, rrënojat e kishës St Urban të shekullit XIII, rrënojat e dy burimeve të lashtë).

Shumë turistë që vizitojnë qendrën historike të qytetit të Tivarit me kështjellën e tij të vjetër, mund të vizitojnë edhe pemën e vjetër të ullirit në Mirovica. Kjo mund të ndihmojë zhvillimin e turizmit në Džidžarin, përgjatë rrugës ndërmjet qendrës historike të Tivarit dhe Pemës së vjetër të ullirit. Turi që fillon nga kanioni i lumit Buna drejt Džidžarinut dhe qytetit të vjetër të Tivarit paraqet një mundësi unike në zonën bregdetare të Malit të Zi, duke ofruar relieve piktoreske, monumente historike dhe kulturore – kisha katolike dhe ortodokse dhe xhami, mure të lashtë guri dhe ujvara.

Zona e Ulqinit ka joshje turistike për arsye të pranishmë të burimeve natyrore dhe kulturore. Bregdeti i saj i famshëm përfshin plazhe të ngushtë, disa me rërë, të tjerë me zhavorr dhe rërë dhe të tjerë me guralecë. Burimet më të rëndësishme arkeologjike dhe historike janë kalaja me rrënojat e mureve cikloprike dhe pazari i vjetër, varret ilire të përhapura në fshatin Zogaj, xhamitë dhe kishat e vjetra, varri Sabbatai Zevi në kullën Balshaj brenda kalasë.

Për më tepër, këto vende evokojnë Servantesin, novelistin e shquar spanjoll që besohet se u burgos në këto anë. Ai u frymëzua nga emri latin i qytetit të Ulqinit - *Dulcinea*, për ta quajtur kështu gruan që dashuronte Don Kishoti.

Arnold von Harff – një udhëtar Gjerman në pelegrinazhin e shekullit XV në Ulqin, la një fjalor me fjalë shqip – I dyti më i vjetër i shkruar në këtë gjuhë. Gjithashtu njihen edhe beteja navale si ato ndërmjet anijeve Britanike dhe Franceze dhe piratëve të Ulqinit Lika Ceni dhe Haxhi Ali në vitin 1772. Ymer Agë Ulqini është ende gjallë në këngët tradicionale për mbajtjen e premtimit të tij ndaj mbretit të Spanjës dhe gruas së tij për rikthimin në burg...

Kompozitori italian Leopold de Wenzel (1847-1923), frymëzuar nga vallet tradicionale të Ulqinit shkroi *Dulcigno Polka*.

Xhamia e Lamit (1689) dhe xhamia e Pashait (1719) kanë arkitekturë tipike dhe një hamam unik.

Muri Ciklopik Ilirian që ndodhet pranë kalasë dhe kullës së Balshajve, që daton 2500 vjet më parë, është një pikë me interes të përbashkët me murin e Venafro Caton.

Në zonën e Džidžarinut, janë regjistruar 294 specie bimësh të egra, prej të cilave 2 mbrohen nga legjislacioni vendas dhe 6 janë specie endemike të gjetura në buzë shpatit të malit Rumija. Prania e disa habitateve natyrore është rezultat i praktikave ekstensive të fermës që shpesh rezultojnë në braktisje të ullishteve.

Bollëku floreal në ullishtet ofron mundësi të reja për turizmin me shtimin e bimëve barishtore për qëllime mjeksore dhe të specieve endemike të mbrojtura dhe bimëve të ngrënshme për përdorim kulinar.

Në Gjirin Valdanos, vegetacioni kryesor janë pyjet me gjelbërim të përjetshëm (NATURA 2000: 9320 – ullinj dhe carrob), dominuar nga ullinjtë e egër (*Olea europea* ssp. *Sylvestris*) dhe carrob (*Ceratonia siliqua*). Vegetacioni Psamofit dhe halofit, dhe bimësia e ujrave të kripura gjenden gjithashtu në Plazhin e Madh në Ulqin; ky tip vegetacioni është zhdukur nga brigjet e tjera të Adriatikut. Në ujrata e kripura të Ulqinit, ka popullata halofite që mbulojnë baltovinat të cilat janë të rralla në brigjet e Adriatikut. Bashkësia e gëmushave përfshin *Quercus coccifera* dhe *Fraxinus ornus*, por gjithashtu *Quercus ilex* në Liman afër Ulqinit, poshtë fshatit Komina në bregdet, në veri të ishullit të Ulqinit të Vjetër, *Quercus pubescens* në Zogaj dhe Krythe pranë Ulqinit, dhe *Quercus coccifera*.

2.3. Mjedisi Social-ekonomik i zonave të projektit

Në të tre zonat rurale të **Shqipërisë** aktiviteti kryesor ekonomik është bujqësia. Kohët e fundit në vend ka ndodhur një modernizim domethënës i fabrikave të përpunimit të ullirit duke rritur konsumin e vajit të ullirit në një vend ku konsumi për frymë i tij ka qenë gjithmonë shumë i ulët, duke qenë se është përdorur kryesisht si ilaç. Sot konsumatori shqiptar është i gatshëm të paguajë një çmim të lartë për vajin e ullirit ekstra të virgjër.

Në zonën **Marikaj**, pronar i fabrikës më të rëndësishme të vajit të ullirit është një prej operatorëve kyç në rajon, familja Subashi që është shumë aktive në sektorin e ullirit dhe atë të vajit të ullirit dhe në promovimin e sektorit të ullirit dhe atij kulturor dhe eno-gastronomik. Kjo familje ka në pronësi një ullishte me 1,200 rrënjë ullinj 500 vjeçarë, të varietetit Kalinjot, të quajtur “Ullishtja e Skënderbeut” dhe gjithashtu ajo merret me prodhimin e sapunëve të aromatizuar me bazë vaj ulliri, erëza të paketuara, çaj të vendit, suvenire me dru ulliri dhe shumë tipe vaj ulliri të aromatizuar me erëza.

Në **Prezë** aktiviteti bujqësor është diversifikuar duke përfshirë turizmin në fermë si rrjedhojë e pranisë së një trashëgimie të pasur kulturore, përfshi kalanë mesjetare, dhe të gadishmërisë për të investuar në infrastrukturën rurale.

Në **Marikaj** dhe **Prezë** ka prodhime artizanale lokale që lidhet me përpunimin e drurit, i cili nuk gjen treg tjetër përveç qendrave të afërta. Në fakt, suveniret që tregtohen më së shumti janë produkte industriale të importuara nga vende të tjera. Kufizimi i prodhimit artizanal është pasojë e mungesës së kompetencës dhe profesionalizmit, përveç mungesës së gjenerimit të të ardhurave dhe përfshirjes së grave.

Në zonën e **Ndroqit** bujqësia është sektori kryesor ekonomik, që bazohet në kultivimin e ullirit dhe pemëve frutore. Përveç vajit të ullirit, përpunohen edhe prodhime të tjera bujqësore si vera dhe reçelrat e frutave me metoda tradicionale.

Nuk ka aktivitete artizanale, por kalaja e Ndroqit është përdorur nga artizanët për të bërë tregti me zonat e tjera.

Atraksionet turistike në zonën e Ndroqit kanë të bëjnë me traditën vendase gastronomike dhe prodhimin bujqësor. Ka lëvizje turistësh që vizitojnë Ndroqin për pak orë për arsye të mungesës së shërbimeve të turizmit, mungesës së informacionit mbi vendet historike dhe kulturore dhe burimeve natyrore të zonës.

Tre zonat e përzgjedhura që ndërveprojnë nëpërmjet shkëmbimeve tregtare kanë një potencial të madh për rritjen e turizmit të qendrueshëm për arsye të afërsisë së tyre me kryeqytetin, Tiranën, qyteti më i madh në Shqipëri me një milion banorë dhe mijra turistë të huaj që e vizitojnë atë çdo vit.

Prania e aseteve kulturore dhe natyrore, të tilla si liqeni, lumi Erzen, zonat pyjore, përveç ullishteve shekullore, përbëjnë elementë që duhet të përdoren për të stimuluar e promovuar aktivitete të reja turizmi. Përdorimi i qendrueshëm i këtyre burimeve mund të jetë një forcë udhëheqëse për zhvillimin ekonomik që mbështetet në turizmin e qendrueshëm.

Venafro karakterizohet nga një aktivitet bujqësor ekstensiv. Bazuar në morfologjinë e territorit të Venafros, mund të dallohet fusha e madhe për kulturat bujqësore dhe serrat si edhe brezi i kodrinave i destinuar për rritjen e ullirit pa qëllime përfitimi dhe me metoda miqësore me mjedisin. Fermat blegtorale, veçanërisht për

prodhim qumështi, luajnë një rol të rëndësishëm si sektor kryesor. Ky është një aktivitet tradicional që ende mbijeton në sajë të cilësisë së lartë të produkteve lokale dhe të përfshirjes së territorit të Venafros në zonën e prodhimit të *Mozzarella di Bufala Campana*, *Ricotta di Bufala Campana* dhe *Caciocavallo Silano* PDOs.

Ndonëse bujqësia praktikohet gjerësisht brenda zonës së bashkisë, të dhënat që lidhen me menaxhimin e fermës dhe madhësinë ekonomike të ekonomive familjare tregojnë për një brishtësi të qenësishme, dhe të dhënat për shpërndarjen e fermave organike pothuaj mungojnë krejtësisht këtu.

Në zonën e Venafros ka tre fabrika të përpunimit të vajit të ullirit, si edhe tre ndërmarrje të reja bujqësore fokusuar në rritjen e cilësisë së prodhimeve bujqësore, të stimuluar nga Parku Rajonal i Ullirit në Venafro. Këto ndërmarrje, Luca Del Prete dhe *Arco Antico* që merren me prodhime organike DOP, dhe Colonia Julia janë anëtare të markës kolektive Europiane "*Terre degli Olivi di Orazio*" që është rregjistruar nga Parku.

Artizanati në Venafro është pak i zhvilluar, ndonëse artistë të vërtetë që merren me gdhendjen e drurit të ullirit, e ushtrojnë atë si hobi. Ndër profesionistët e sektorit ia vlen të përmenden artizanët e rinj që krijojnë mozaikë artistikë qelqi dhe mermeri dhe realizojnë riprodhime të mozaikëve Romanë dhe Grekë duke **vënë në pah** shumë objekte të gjetura në vilat Romane që tashmë ruhen në Museun Kombëtar Arkeologjik në Venafro. Një aktivitet tjetër i rëndësishëm është edhe ai i suvenireve të qeramikës dhe poçeria.

Atraksioni turistik në Venafro është ndikuar pozitivisht nga furnizimi i përshtatshëm me prodhime tipike dhe të lidhura ngushtë me territorin e Parkut: ëmbëlsirat e Venafros, që janë zhvilluar si produkte rikuperimi nga mbetjet e brumit të bukës; *Signora di Conca Casale*, një salçiçe derri prodhimi i së cilës daton 200 vjet më parë: sot prodhohet edhe për qëllime komerciale (rreth 600 copë në vit) nga një prodhues sallamesh prej Conca Casale dhe është certifikuar si P.A.T (Produkt Alimentar Tradicional Italian) nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Pyjeve dhe gjithashtu është njohur nga Slow Food Presidium; *Spezzato di Ceppagna*; një gatim me mish dele që ka një vlerë historike-kulturore dhe gastronomike për të gjithë katundin Ceppagna dhe që është një gatim unik gjatë festimeve në nder të "Our Lady of the Rosary", shenjtorese së fshatit; *panettone "Panevo"* prodhuar nga furra e bukës Ricci nga Montaquila që bëhet me vaj ulliri ekstra të virgjër nga Venafro në vend të gjalpiti; Bira e aromatizuar me degë ulliri, lançuar në Venola në 2019.

Në Mal të Zi, prodhimilive i vajit të ullirit vlerësohet në 400-500 ton. Sasitë e prodhuara nuk janë të mjaftueshme për plotësimin e nevojave të vendit.

Ullishtet në Tivar numërohen nga 600-800, por vetëm 350-400 i përdorin ullishtet si burimin e vetëm të të ardhurave, duke qenë se fermerët kanë në pronësi 50-100 ullinj.

Për të kontrolluar cilësinë aplikohet regjistrimi i fermave në regjistrin kombëtar të tokës. Megjithatë, sfida është zbatimi në praktikë i udhëzimeve për përmirësimin e standarteve të cilësisë në prodhimin e ullirit.

Përpunimi i ullirit ndodh ende, kryesisht në punishte të cilat nuk plotësojnë standartet ndërkombëtare, ndonëse janë bërë përpjekje të mëdha vitet e fundit në zbatimin e praktikave agroteknike dhe në modernizimin e punishteve. Ka 6 punishte përpunimi.

Disa kultivues ulliri kanë filluar të përdorin etiketa për vajin e tyre të ullirit, vitet e fundit është vënë re rritje e sektorit, me projektet e BE që synojnë përmirësimin e marketingut të ndërmarrjeve të vogla e të mesme.

Prodhimi lokal i vajit është kryesor në kuzhinën tradicionale dhe gjithashtu ka iniciuar aktivitete artizanale që lidhen me prodhimin e sapunëve dhe produkteve kozmetike me bazë vaj ulliri. Në Tivar është edhe fabrika e parë e sapunit, "Barska sapunara", krijuar në vitin 1888, e cila ka furnizuar me këtë produkt Familjen Mbretërore Malazeze. Prodhimi i sapunit është një praktikë tradicionale pothuaj në të gjitha ekonomitë shtëpiake në Tivar dhe ende ka potencial, duke pasur parasysh kërkesën e tregut për produkte kozmetike natyrale.

Ka vetëm pak artizanë që merren me prodhimin e objekteve të drurit të ullirit, ndonëse vitet e fundit ka pasur një rritje kërkesë për këto produkte, dhe prodhimi ka filluar të plotësojë kërkesën e tregut. Ka nevojë për të trajnuar artizanët sa i takon përmirësimit të dizajnit dhe etiketimit.

Ndër produktet ushqimore të zonës, duhet përmendur djathi feta i butë, i prodhuar në mënyrë artizanale. Gjithashtu ka receta tradicionale të gastronomisë lokale përfshi vajin e ullirit dhe ullinj të tavolinës të varietetit nativ Žutica, përveç përgatitjes së peshkut dhe Japrakut i cili bëhet me mbështjellje gjethesh rrushi. Ullinj të Tivarit, qoftë jeshilë qoftë të zinj, duhen mbrojtur si specialitete gastronomike lokale.

Në Džidžarin ka shembuj të turizmit aktiv, të tillë si kanionet në lumenjtë Suva, Vruća dhe Buna; marshimet (hiking) në shtigjet me sinjalistikë në shpatet e Lisinjit (ku ndodhet Džidžarin), interesante për vëzhgimin e zogjve (birdwatching); peshkimi rekreativ në lumenjtë Vruća dhe Buna.

Turi i marshimit nga St. Vić në Sustaši kalon përmes zemrës së ullishteve të Tivarit, me ngjitje në kodrën e Kurilos, që ofron një pamje të qytetit që të lë pa frymë. Ka rrugë me kalldrëm ideale për ecje, vrap dhe biçikleta, që lidhen direkt me rrugët kryesore dhe autostradën. Për këtë arsye kjo ullishte ka potencial të kthehet në një zonë aktive pushimi për banorët e vendit.

Në vjeshtën e vonë, oferta e agroturizmit përfshin pjesëmarrjen aktive të turistëve në aktivitetet e vjeljes dhe përpunimit të ullirit.

Biznesmenë anglezë dhe australianë kanë blerë fabrikën Duke Maša Vrbica në vitin 1882 dhe të udhëhequr nga fuqia e lumit Buna e adoptuan atë në një hostel.

Në Fortesën (Kështjellën) e Vjetër të Tivarit organizohen shumë evente. *Maslinijada* është një event që organizohet që prej vitit 2002, e që sjell së bashku prodhuesit e produkteve lokale të rajonit, ndërsa *Maslinom Susreti pod Starom* është një event për fëmijët që organizohet në ullishtet shekullore dhe sjell së bashku shkrimtarët e njohur të rajonit.

Oferta turistike për vizitë në qendrën historike të qytetit Tivar (me pjesëmarrje të 100,000 personave vitin e kaluar) duhet integruar me shërbime turistike, të tilla si agroturizmi, turizmi kulturor dhe aktiv, që do të mundësojnë zgjatjen e kohës së qëndrimit të turistëve në zonë.

Aktiviteti kryesor ekonomik në **Ulqin** është bujqësia me dominues kultivimin e ullirit, si edhe bimbësisë së butë, bimëve medicinale dhe specieve të ndryshme të frutave (fiq, agrume, gështenja, shegë, mollë, dardhë, kumbull), vreshtave dhe drithrave. Produkte të tjera agro-ushqimore në Ulqin përfshijnë kivit, domatet dhe specat, të cilat janë eksportuar tradicionalisht në republikat e tjera të ish-Jugosllavisë. Produkte të tjera janë vera dhe rakia.

Zona e Ulqinit ka një numër të madh restorantesh, hotelesh, B&B si edhe së fundmi ferma agroturizmi që ofrojnë një gamë shërbimesh të nevojshme për zhvillimin e turizmit. Te tjera shërbime atraksioni turistik lidhen me sërfin me vela, dhe itineraret në shtigjet e marshimit që ndodhen në zonat pyjore dhe në ullishtet shekullore.

Vitet e fundit shtë rritur numri i B&B të ngritura ilegalisht në ullishtet shekullore, duke kompromentuar historinë panoramike të këtyre ullishteve.

2.4. Instrumentet e planifikimit të tokës në zonat rurale të ullishteve

Pas ndryshimeve politike të viteve 1990, të gjitha **ullishtet në Shqipëri** u privatizuan me Ligjin 7501, kështu çdo pemë ulliri ka një pronar, i cili përgjigjet për prodhimin.

Ka një mungesë të planifikimit për zhvillimin ekonomik i cili është spontan dhe i pakontrolluar duke rezultuar me humbje ose shkatërrim të burimeve të cilat janë shumë të rëndësishme për zhvillimin e turizmit të qendrueshëm.

Legjislacioni për mbrojtjen e ullinjve monumentalë për të lehtësuar identifikimin dhe praktikën për ruajtjen e tyre mungon. Jetëgjatësia e tyre është në rrezik dhe vaji i prodhuar nga këta ullinj nuk promovohet për vlerat e tij reale.

Fshati Marikaj është përzgjedhur nga qeveria dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Përdorimit të Tokës si pjesë e programit “100 fshatrat” që pritet të marrë mbështetje për zhvillimin e infrastrukturës, turizmit kulturor dhe iniciativave komerciale.

Parku Rajonal Bujqësor Historik i Ullirit në Venafro është krijuar me Ligjin no.30 të vitit 2008. Ai menaxhohet nga një njësi ligjore me identitet sipas ligjit publik dhe është subjekt supervizimi nga Rajoni Molise.

Parku ka si qëllim të promovojë ruajtjen, restaurimin dhe rigjenerimin e mjedisit natyror, relievit historik-bujqësor dhe tipareve arkitekturore “të historizuara”, dhe të trashëgimisë arkeologjike, historike dhe etno-antropologjike. Për më tepër, ai ka synimin të mbrojë burimet gjenetike të ullinjve të Venafros dhe të promovojë përhapjen e kultivarëve të ullirit që rriten në rajonin Venafro.

Një instrument tjetër për mbrojtjen e ullishteve në pjesën e sipërme të Parkut është përfshirja e tij në zonën SIC (Site of Community Interest IT7212171) të *Monte Corno Monte Sammucro*. Në përputhje me RDP 2007/2013 (Masa 3.2.3, Akti A “Mbështetje për hartimin e planeve të menaxhimit të vendeve që ndodhen në zonat Natura 2000”) u hartua plani i menaxhimit për mbrojtjen e natyrës të zonës, ndonëse nuk është vënë ende në veprim për arsye të mungesës së një trupe menaxhimi.

Pjesa më e madhe e zonës, sipas Planit të Strukturës Hidrogeologjike, është kufizuar nga Autoriteti për basenet e lumenjve Liri, Garigliano dhe Volturno për arsye të rrezikut të rrëshqitjeve të dheut në pjerrësi të mëdha.

Trashëgimia arkeologjike e parkut, që konsiston në muret Romanë, Samnite, rezervuarët dhe rrënojat e vilave rustike Romane është nën juridiksionin e Superintendencës Arkeologjike të Arteve të Bukura dhe Relievit të Rajonit Molise.

Parku i Ullirit në Venafro është listuar gjithashtu në regjistrin kombëtar të relieveve rurale historike me dekret no. 6419 të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Pyjeve dhe Politikave Turistike të datës 20.02.2018.

Gjithashtu ka edhe një Plan të Zhvillimit të Turizmit të Provincës Isernia dhe një MUST Plan Strategjik (për musetë dhe zhvillimin e sistemit territorial) të hartuar nga Ministria e Trashëgimisë dhe Aktiviteteve Kulturore për luginën e sipërme të Volturnos. Ky Plan Zhvillimi Kulturor Strategjik përcakton “Paths of Water and Stone”, dhe ka përfshirë njësitë dhe komunitetet vendore, përfshi edhe Parkun.

Plani për Zhvillimin Vendor Mjedisor Turizmit dhe Ekonomik (LEETDP), hartuar nga autoriteti i Parkut nëpërmjet këtij projekti, synon të priorizojë një zonë me potencial të madh kulturor dhe natyror por me një shkallë të lartë të fragmentimit social, braktisje, vjetërim të popullsisë dhe një nivel të ulët aftësisë për përmirësimin e trashëgimisë mjedisore dhe arkitekturore.

Në Mal të Zi legjislacioni që lidhet me sektorin e vajit të ullirit rregullohet me ligjin kombëtar të vitit 2012, të harmonizuar me kuadrin ligjor të BE. Gjithashtu, ka edhe udhëzime dhe rregullore që parashikojnë masat për cilësinë e vajit të ullirit sipas standarteve të BE, të cilat janë pjesë e strategjisë kombëtare për zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale për periudhën 2015-2020. Kjo strategji përfshin programin e granteve nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për mbështetjen e prodhimit të ullirit dhe vajit të ullirit.

Ka edhe një shërbim këshillues kombëtar që mbështet fermerët e ullirit për të adoptuar standartet e prodhimit sipas udhëzimeve të BE.

Marka e tregut për mbrojtjen e origjinës gjeografike të produktit do ti japë identitetin dhe njohjen ligjore etiketimit “Vaj Tivari”.

Ka edhe një projekt të Qeverisë malazeze e cila alokon fonde prej 1 milion Euro për ndërtimin e Shtëpisë së Ullirit në qytetin e vjetër të Tivarit. Kjo strukturë do të pajiset me një zonë ekspozimi, museun e ullirit, një holl prezantues etj. Shtëpia e Ullirit do të jetë edhe Zyra qendrore e Shoqatës Kombëtare të Malit të Zi për kultivuesit e ullirit.

Një projekt tjetër, i zhvilluar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, i quajtur “1 milion pemë ulliri në vitin 2020”, është ai që mbështet mbjelljen e ullishteve të reja në bashkinë Ulqin, por ky projekt nuk është përfunduar ende.

Si rezultat i një zjarri në vitin 2018, i cili shkrumboi 1000 pemë shekullore ulliri, qeverisja vendore ka përcaktuar një plan rivitalizimi të zonave të ullishteve, duke përfshirë pronarët nga taksat për 5 vite me rradhë.

Vitet e fundit ka pasur një rritje të numrit të B&B të ndërtuara ilegalisht në ullishtet e vjetra, duke kompromentuar relievin historik të tyre. Duhet të adoptohen instrumente për mbrojtjen ndaj ndërtimeve të pa autorizuar dhe shkatërrimit të mundshëm, si në nivel lokal edhe kombëtar, për të mbrojtur relievin rural të ullishteve të vjetra që shtrihen nga St. Vić në Sustaši.

3. Potencialet dhe mangësitë e zonave të projektit

3.3. Mangësitë ekzistuese në zonat e ullishteve

Më poshtë listohen mangësitë më kryesore të cilat nuk sigurojnë mbrojtjen dhe shfrytëzimin e plotë të ullishteve të vjetra në të tre vendet:

Në Shqipëri:

- Mungesë e mbrojtjes ligjore të ullishteve të vjetra
- Mungesë e menaxhimit dhe mirëmbajtje e ulët që sjell degradim të zonave me ullishte dhe rreziqe zjarri
- Keqmenaxhim i burimeve natyrore
- Mungesë katalogu (baze të dhënash) të aseteve mjedisore dhe kulturore
- Zhvillim ekonomik i pa planifikuar dhe i pa kontrolluar
- Rrjet i varfër njësisht tregtimi për prodhimet vendore
- Dështim në përdorimin e ujit për të plotësuar nevojat e popullsisë lokale, me mungesë të furnizimit me ujë dhe shkarkime të pakontrolluara të ujrave të ndotura në lumenj
- Humbje ose degradim i burimeve dhe vlerave lokale, të cilat janë elementë të zhvillimit dhe atraksionit turistik.

Në Venafrò:

- Mungesë shërbimesh në zonat përreth Parkut, i cili ka një potencial të madh për zhvillimin e turizmit të qendrueshëm
- Turizëm ditorm me përjashtim të hapjes së Museut Arkeologjik dhe kështjellës mesjetare
- Zhvillim industrial me fabrika që ndotin (fabrika çimentoje dhe përpunimit të mbeturinave) në zonën Venafrò, e cila është krejtësisht bujqësore
- Bashkëpunim i ulët ndërmjet operatorëve, sidomos ndërmjet prodhuesve të ullirit
- Ndërprerje e mbështetjes financiare nga Rajoni për menaxhimin e Parkut, me pasojë vështirësi administrative
- Kullotje e pa autorizuar e gjedhit ndërmjet tarracave të ullishteve, me rrezik për erozion dhe probleme hidrologjike
- Supervizim i pamjaftueshëm nga grupi pyjor i Karabinierëve përgjegjës për kontrollin e tokës
- Braktisje dhe menaxhim i keq i ullishteve në zonat marginale
- Moshë e vjetër e fermerëve dhe gjenerim i fitimeve të ulta, e kompensuar pjesërisht vetëm nga interesi i profesionistëve për blerjen e ullishteve me vlerë për përdorim çlodhjeje, pushimesh.
- Fragmentim i tokës, tendencë e ulët për inovacion dhe mungesë e një zinxhiri të qendrueshëm furnizimi
- Braktisje e praktikave tradicionale në ullishte
- Mungesë e masave specifike për relievin historik rural në Molise
- Tendencë e ulët për investime për qëllime turizmi në zonat rurale, ndonëse hapja e muzeut, kështjellës dhe ngritja e Parkut kanë kontribuar në rritjen e turizmit
- Mungesa e njohjes së vlerave dhe burimeve natyrore nga popullsia lokale
- Organizim i dobët i ofertave turistike për arsye të vështirësive karakteristike të Venafrò (p.sh. teatri Roman është e vështirë të vizitohet)
- Qasje jo bashkëpunuese publik-privat në ofrimin e eventeve që shpjen në çorganizim të kalendarit të eventeve

Në Mal të Zi:

- Braktisje dhe menaxhim i gabuar i ullishteve të vjetra që rezultojnë në rrezik të lartë zjarri
- Njësitë e përpunimit nuk plotësojnë standartet ndërkombëtare
- Menaxhim i papërshtatshëm i ullishteve të vjetra me ndërhyrje abuzive që shkaktojnë bllokim të shtigjeve dhe ndërtime ilegale të pakontrolluara për qëllime turizmi, që kompromentojnë relievin historik të ullishteve

- Mos menaxhim i fluksit të turistëve që shkakton dëmtim të vendeve historike ose të mureve të gurtë
- Mungesë e praktikave të mira për rigjenerimin e ullishteve të vjetra të braktisura nëpërmjet krasitjes
- Humbje e njohurive për ndërtimin e tarracave me mure me gurë të thatë (pa llaç)
- Përhapje e sëmundjeve si *Xylella fastidiosa*
- Mungesë e zbatimit të plotë të kuadrit rregullator për sektorin e ullirit
- Mungesë trajnimi, eksperiencë e kufizuar me kompjuter dhe aftësi të gjuhës angleze nga prodhuesit lokalë
- Vështirësi për të përballuar kostot e blerjes së pajisjeve moderne për prodhimin dhe përpunimin e ullirit
- Prodhim i pamjaftueshëm i vajit të ullirit për të plotësuar nevojat e vendit që reflektohet me çmime të larta në tregun domestik
- Mosmarrëveshje lidhur me pronësinë ligjore të ullishteve
- Mungesë e politikave për zhvillimin e tokës
- Mungesë uji
- Prodhim i pamjaftueshëm i produkteve artizanale që nuk rrit vlerën e përpunimit të drurit të ullirit dhe që penalizohet nga marketingu i papërshtatshëm, dhe aftësitë e kufizuara për dizajnin dhe paketimin
- Diversifikim i pamjaftueshëm i produkteve artizanale
- Mungesë e ndërveprimit të kultivuesve të ullirit dhe turistëve që vizitojnë qytetin e vjetër të Tivarit
- Informacion i papërshtatshëm i turistëve lidhur me prodhimin lokal të ullirit
- Disa shtigje nuk mirëmbahen, nuk kanë sinjalistikë dhe janë bllokuar nga shkurret
- Situata e pandemisë Covid-19 kërcënon potencialin turistik të ullishteve

3.4. Potencialet e zonave të kultivimit të ullirit

Më poshtë janë listuar potencialet e zonave në studim që mund të sigurojnë menaxhimin e duhur dhe përmirësimin e ullishteve të vjetra në të tre vendet:

Në Shqipëri:

- Prania e trashëgimisë kulturore që së bashku me traditën e zonës paraqet potencial për zhvillim të qendrueshëm të zonës
- Zonat kodrinore me pamje panoramike me vlerë të lartë piktoreske
- Disponueshmëria e burimeve natyrore dhe bollëku i burimeve ujore
- Potencialet për përpunimin e prodhimeve bujqësore (vaj ulliri, verë, mjaltë etj.) të cilat ndikojnë pozitivisht në zhvillimin e turizmit në zonë
- Shtrirja e kultivimit të ullirit në të gjithë zonën, menaxhimi me metoda tradicionale me linja cilësore përpunimi
- Ullishte monumentale atraktive për vizitorët me iniciativa për turizmin që kanë filluar tashmë në Marikaj
- Lidhjet e mira me fshatrat përreth, afërsia me aeroportin dhe zona të tjera të rëndësishme urbane (Tiranë, Durrës)
- Komunitete me nivel mesatar edukimi dhe institucione edukuese që funksionojnë mirë
- Elementë tradicionalë ende të pranishëm, të tilla si mullinjtë e vjetër të vajit, punimet artizanale, kalatë, muzetë
- Aktorë vendas në fshat të interesuar për investime në turizëm.

Në Venafrë:

- Ullishtet e vjetra me karakteristika të spikatura të relievit, të lavdëruara nga Horaci dhe autorë të tjerë të shekujve të mëparshëm
- Flora e bollshme dhe e shumëllojshme në ullishte, me 302 specie të identifikuar
- Përfshirja në Regjistrin Kombëtar të relieveve historike rurale të MIPAAF që ka potencialin të tërheqë investime direkte, projekte dhe financime për përmirësimin e këtyre zonave, dhe që ofrojnë mundësi për

kompanitë lokale që të mbajnë markën e certifikimit të relievit rural të promovuar nga ISMEA me bonuse për kompanitë që marrin pjesë në tendera publike

- Relievi, cilësitë historike, arkeologjike dhe natyrore të një zone marginale të rritjes së ullirit si mjet për përmirësimin e kontekstit mjedisor dhe bujqësor gjithashtu me mbështetje të iniciativës publik-privat
- Historia e shoqëruar me cilësinë e produktit, me citate të Horacit, Plinit dhe autorëve të tjerë romanë që përfaqësojnë një certifikatë të parë historike “cilësie”
- Pozicioni strategjik gjeografik i Venafros, aktivitetet e rëndësishme të përbashkëta dhe trafiku me Napolin, Romën dhe Peskarën
- Kreativiteti që karakterizon numrin e vogël të aktiviteteve artizanale të lidhura me territorin (p.sh. riprodhimi i mozaikëve që lidhen me një numër artifaktesh Romane të gjetura në zonë)
- Historia e kultivimit të ullirit dhe prodhimit të vajit të ullirit në Venafro si element atraksioni për turizmin e përzgjedhur dhe të vetëdijshëm (p.sh. event i Venolës, Marshimi Kombëtar në ullishtet, Pasioni dhe organizmi i tureve me temë ullirin).

Në Mal të Zi:

- Potencialet për prodhimin bujqësor (frutat e kultivuara dhe të egra) dhe prodhimet për përpunim (vaji ullirit, vera, mjalti, bimët medicinale) që ndikojnë pozitivisht në zhvillimin e turizmit në zonë
- Përhapja e kultivimit të ullirit në zonë dhe inkurajimi nga Ministria e Bujqësisë nëpërmjet projektit “1 milion pemë ulliri” që synon promovimin e mbjelljeve të reja në zonë
- Prania e dy shoqatave aktive të kultivuesve të ullirit të angazhuara në asistencën teknike për fermerët dhe iniciativat e turizmit
- Projektet e fundit për mbështetjen e marketingut
- Disponueshmëria e shërbimeve turistike (restorante, hotele, B&B, biznese të agroturizmit, kanionet, ekskursionet, turet me biçikleta etj.) dhe burimet tradicionale natyrore dhe gastronomike
- Prania e shtigjeve brenda ullishteve për këmbësorë dhe biçikleta që lidhen direkt me rrugët kryesore dhe autostradën që përbëjnë një potencial për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm në komunitetet lokale
- Mundësitë për turizmin që lidhen me ullishtet në Džidžarin, që ndodhen përgjatë rrugës ndërmjet qendrës historike të Tivarit dhe Pemës së Vjetër të Ullirit
- Tradita e gjatë e turizmit në zonë që mburret me burimet natyrore dhe historike, përveç njohjes si monument natyral në vitin 1968 të Gjirit të Valdanos
- Potenciali financiar për fonde të BE për bujqësinë dhe prodhimin e ullirit
- Disponueshmëria e drurit të ullirit dhe aftësive njerëzore si edhe eksperiencia për artizanatin lokal
- Kërkesa në rritje e tregut për prodhime artizanale
- Monumentet e rëndësishme historike dhe kulturore dhe vendet arkeologjike në qendrën historike të Tivarit dhe në ullishtet përreth (kishat, xhamitë, urat etj.)
- Mundësia e zgjatjes së sezonit turistik gjatë sezonit të vjeljes së ullirit duke propozuar shërbime për turizmin eksperimental
- Interesi i biznesmenëve të huaj për të investuar në objekte dhe shërbime të turizmit rural

4. Harta e praktikave të mira për menaxhimin e qendrueshëm dhe përmirësimin e ullishteve të vjetra

Aktualisht, në të tre vendet e projektit / zonat target shumë iniciativa bazohen në kriterin e identifikuar për zhvillimin e turizmit në ullishtet e vjetra. Një arritje e rëndësishme në këtë drejtim është Parku Historik i Ullirit në Venafrò. Eksperienca të tjera të suksesshme mund të gjenden në rajonin e Apulias, të cilat do të përshkruhen shkurtimisht më poshtë.

Parku Rajonal Bujqësor Historik i Ullirit në Venafrò

Aktiviteti i tij ka filluar në vitin 2011, me iniciativa që synojnë ripërdorimin e ullishteve të abandonuara, tërheqja e turistëve nëpërmjet rihapjes së vendkalimeve të lashta dhe shtigjeve. Qëllimi është krijimi i një modeli për promovimin e relievit historik rural Italian.

Autoriteti i Parkut kryen një aktivitet intensiv promovues me pjesëmarrje në evente të ndryshme në të gjithë Italinë, me publikime të broshurave dhe librave, organizimin e eventeve kombëtare të tilla si VENOLEA që, gjatë viteve, kanë parë pjesëmarrjen e ekspertëve lider nga universitetet dhe qendrat kërkimore italiane.

Një nga qëllimet kryesore është rishkrimi në terma moderne i historisë madhështore që lidhet me vajin e ullirit të Venafròsë. Janë vendosur marrdhënie me vende të tjera mitologjike dhe fetare kultivuese të ullirit, të tilla si Dega e Fondacionit Taybeh-Efraim–Palestine dhe së bashku me partnerë nga Toskana menaxhimi i ullishtes Gethsemane i është propozuar organizatës “Custody of the Holy Land”.

Marka “Terre degli Olivi di Orazio”

Për të stimuluar cilësinë e produkteve të ullishteve tradicionale të Venafròs, Autoriteti i Parkut ka regjistruar markën e cilësisë kolektive BE “Terre degli Olivi di Orazio”, e cila plotëson mungesën e aderimit në PDO Molize, që është e vështirë të realizohet në kushtet e një zone kultivuese ulliri shumë të fragmentuar dhe me ferma shumë të vogla. Specifikimet e produktit janë aprovuar për vajin e ullirit, produktet e brumit, fidanishtet që prodhojnë fidane ulliri autoktone dhe objektet akomoduese. Marketingu i produkteve bazohet në shitjet e drejtpërdrejta. Fermat marrin pjesë në panaire dhe konkurse, pra duke promovuar kultivimin e ullirit të Venafròs.

Venolea

Autoriteti i Parkut promovon kultivimin e ullirit dhe produktet e tij gjatë gjithë vitit me iniciativa turizmi dhe testimi të produkteve. Eventi kulminant në fund të vitit është Venolea, që sponsorizohet nga MIPAAF, Rajoni Molise dhe Shoqata Kombëtare e Qyteteve të Vajit, me një mbulim të konsiderueshëm nga mediat kombëtare. Eventi gjithashtu përfshin prodhues nga vendet fqinje dhe adreson çështje që lidhen me kultivimin e ullirit.

Përfshirja e Parkut Rajonal të Ullirit Venafrò në Regjistrin Kombëtar të terreneve historike rurale

Terreni i Parkut Rajonal Venafrò është përfshirë në Regjistrin Kombëtar të terreneve historike rurale, praktikave bujqësore dhe njohurive tradicionale (me dekret no. 6419 të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Pyjeve, datë 20.02.2018) si një nga 13 terrenet e regjistruar deri tani.

ISMEA – Drejtorja për shërbimet e Zhvillimit Rural është përcaktuar si etiketuesi i çertifikimit të terreneve për përfitim të këtyre zonave të njohura në Regjistrin Kombëtar.

Kjo përfshirje në Regjistrin Kombëtar është një parakusht për vendet e nominuara në Programin Botëror të FAO-s, të quajtur GHIAS (Globally Important Agricultural Heritage Systems), për mbështetjen e fermerëve që sigurojnë biodiversitet, siguri ushqimore dhe kohezion social.

Observatori Kombëtar i Relievit përzgjedh nga Regjistri vendet e propozuara të terreneve rurale për përfshirjen e tyre në Listën Përfaqësuese të Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s, si edhe të praktikave bujqësore dhe njohurive tradicionale. Është e qartë pra se sa e rëndësishme është të përfshihesh në Regjistrin Kombëtar.

Kopshti Italian “Green Patriarchs” (Patriarkët e Gjelbër)

Në këndvështrimin e mbrojtjes së ullinjve “historikë”, është krijuar në Itali, në bashkëpunim me Shoqatën e Patriarkëve Italianë dhe Komitetit të Zbukurimit të Romës, kopshti unik i pemëve të ullirit, kopshti i Patriarkëve. Ai ka mbledhur ekzemplarë të ullinjve të vjetër italianë, nga një për çdo rajon.

Turi Kombëtar i Marshimit në Ullishtet

Zbatuar në bashkëpunim me Shoqatën Kombëtare të Zbukurimit dhe Shoqatën e Qyteteve të Vajit.

Venafro "Living passion"

Ky event, që konsiston në përfaqësimin e gjallë të Pasionit të Krishtit, organizohet në mes të pemëve të ullirit të Parkut Rajonal të Ullirit të Venfros, pranë Katedrales, me pamje unike piktoreske; ai është një nga të parët e krijuar në Itali dhe prezantuar në vitin 1967.

Eventi organizohet në një peisazh të jashtëzakonshëm, të krijuar nga lugina Campaglione e ullirit. Është nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi me fshatin biblik të Nazaretit për paraqitjen identike të Pasionit në Palestinë.

Anëtarësimi në Shoqatën Kombëtare të Qyteteve të Vajit

Shoqata Kombëtare e Qyteteve të Vajit ka 30 vjet eksperiencë në promovimin e kultivimit të ullirit nëpërmjet aktiviteteve satelite dhe eventeve ekonomike dhe kulturore si edhe veprimeve me ndikim pozitiv në territor.

Për të krijuar lidhje më efektive të këtyre çështjeve me institucione të tjera, Autoriteti i Parkut ka promovuar koordinimin kombëtar të vendeve historike të ullinjve në Shoqatën Kombëtare të Qyteteve të Vajit.

Rrjeti i shtigjeve për marshim në ullishtet në Džidžarin dhe praktikat e mira të turizmit aktiv

Vendndodhja jo shumë e largët e ullishteve të vjetra nga qendra historike e Tivarit, bën që ato të përshkohen në këmbë nëpërmjet shtigjeve me dëshmi të rëndësishme historike dhe kulturore (ura e vjetër, rrënojat e kishës së shekullit XIII, gjurmët e dy burimeve të lashta të ujit). Turi i marshimit që fillon nga kanioni në brigjet e Bunës drejt Džidžarit dhe qytetit të vjetër të Tivarit (dhe për personat e trajnuar fizikisht i ashtuquajturit shtegu Londža), paraqet një mundësi unike në bregdetin e Malit të Zi, duke ofruar peisazhe piktoreske, monumente historike dhe kulturore, mure të vjetra guri dhe ujvara.

Në Džidžarin gjithashtu përmendim dhe ekskursionet në kanionet e lumenjve Suva dhe Vruća, veçanërisht në lumin Buna, marshimet në shtigjet me sinjalistikë në shpatet e Lisinjit (ku ndodhet Džidžarini), interesante për vëzhgimin e zogjve (birdwatching); peshkimin rekreativ në lumenjtë Vruća dhe Buna.

Pema e Vjetër e Ullirit në Mirovica

Shumë turistë që vizitojnë qendrën historike të qytetit Tivar, shkojnë për të parë edhe pemën e vjetër të ullirit në Mirovica. Kjo është nga pemët më të vjetra të ullirit në botë, e mbrojtur nga legjislacioni kombëtar që në vitin 1957. Instituti i Pyjeve dhe Bujqësisë në Stamboll e ka vlerësuar këtë pemë në moshën 2,245 vjeç.

Mikpritja rurale në punishtet e vjetra

Mulliri i vajit Duke Maša Vrbica që daton në vitin 1882 është adoptuar në një hostel nga biznesmenë anglezë dhe australianë.

Evente për promovimin e produkteve lokale

Maslinijada është një event që organizohet që në vitin 2002, që mbledh së bashku prodhues të produkteve ushqimore lokale të rajonit, ndërsa *Maslinom Susreti pod Starom* është një event për fëmijët që organizohet në ullishtet e vjetra dhe sjell së bashku shkrimtarët më të njohur të rajonit.

Shoqatat e kultivuesve të ullirit të Malit të Zi

Përfshijnë Shoqatën e kultivuesve të ullirit të Tivarit të krijuar në vitin 2002 dhe Shoqatën e kultivuesve të ullirit Antivari të krijuar në vitin 2020 me gjithsej 150 fermerë. Objektivi i shoqatave është shtimi i vlerës së ullirit nëpërmjet mbështetjes së anëtarëve për rinovimin e ullishteve të vjetra të braktisura, krijimin e plantacioneve të reja, përhapjen e teknikave të kultivimit duke synuar përmirësimin e cilësisë. Të dyja shoqatat janë angazhuar edhe në iniciativa të turizmit.

Praktikat e mira të turizmit “slow” shoqëruar me relievin historik të pemëve të vjetra të ullirit në Puglia

Në Puglia ka një zonë rurale, Alto Salento, e cila është fokusuar, në vitet e fundit, në turizmin që lidhet me relievin rural të ullishteve monumentale. Kjo zonë ka rritur atraksionin e turistëve të saj në sajë të politikave të zhvillimit rural të zbatuara nga agjensi të zhvillimit vendor (Grupe Lokale të Veprimet - LAG) dhe autoritetet menaxhuese të zonave natyrore të mbrojtura (Parqet dhe Rezervatet Natyrore) nëpërmjet promovimit të start-upeve që lidhen me mikpritjen, me rigjenerimin e ndërtimeve me vlera historike-arkeologjike (trulli, shtëpitë e fermës).

Rrafshina e ullishteve me ullinj monumentale është një reliev bujqësor mijëvjeçar, por ende i gjallë dhe produktiv, duke qenë se është përshtatur ndaj ndryshimeve në kohë duke ofruar shërbime të reja lidhur me multifunksionalitetin e fermave të ullirit. Shërbimet e reja të shoqëruara me turizmin “slow” dhe të qendrushëm kanë filluar të përdorin modele turizmi që lidhen me kulturën e vajit dhe relievin historik rural.

Zona e Alto Salentos përshkohet nga tre shtigje distancë-gjatë Europiane, shtegu i ujësjellësit Apulian, shtegu Helenik dhe shtegu *via Traiana* ose Francigena në Jug, që kalojnë përmes relievit bujqësor të ullishteve monumentale. Shtegu *Via Traiana* njihet si shtegu nacional distancë-gjatë no.6 e *Bicitalia* (Rruga e biçikletave e Adriatikut (që nga Venecia shpie në Santa Maria di Leuca) dhe si shtegu Francigena në Jug.

Në rrafshinën e ullirit, gjatë shtegut *via Traiana*, ka shumë shtëpi ferme dhe mullinj vaji nëntokësorë, të cilat përfaqësojnë një element kyç për zhvillimin e turizmit për ata që dëshirojnë të udhëtojnë në zonat rurale me ngadalë, duke ndjekur modelin e çfarë është zhvilluar në dekadat e kaluara në *Santiago di Compostela*.

Veprimet e kryera nga LAG kanë si qëllim jo vetëm rigjenerimin e strukturave me vlerë por gjithashtu për të zgjeruar njohuritë e banorëve, operatorëve turistikë dhe fermerëve që operojnë përgjatë këtyre shtigjeve. Një aktivitet trajnues intensiv që synon përmirësimin e marrjes së shërbimeve për çiklistët dhe udhëtarët është nëpërmjet organizimit të “vizitave studimore” në zonat me ekselencë për turizmin (Maremma, Trentino) për rrjetet inter-operatore, kualifikimin e çiklizmit, marshimit dhe shërbimeve të turizmit aktiv.

Kujdes i është kushtuar kualifikimit të operatorëve turistikë për zhvillimin e aftësive profesionale në marrjen e shërbimeve dhe mobiliteteve të qendrushme, ose për të ngritur objekte akomodimi miqësore me çiklizmin në Italinë qender jugore.

Sot, disa kompani ofrojnë shërbime për realizimin e zonave rurale dhe natyrore (ecje në këmbë dhe me biçikletë në ullishte, madje edhe natën, ekskursione mbi kalë, me makina elektrike, me gomerë, testime të vajit të ullirit në oborrin e shtëpisë në ferma historike dhe mullinj vaji nëntokë, teatër live, dhe evente kulturore në ullishte në kontakt të drejpërdrejtë me komunitetet rurale). Këto shërbime jashtë-sezoni dhe inovative krahasuar me shërbimet e vjetra të turizmit “diell-plazh”, kanë krijuar mundësi për të rinjtë dhe gratë duke përmirësuar aftësitë e tyre. Turizmi i vajit të ullirit është një aktivitet që përfshin ekonominë familjare me pemë monumentale ulliri në organizimin e sesioneve të shijimit të vajit të prodhuar nga këto pemë monumentale. Kombinimi Vaj ulliri-Turizëm është i dukshëm në 15 dyqane vaji ulliri në qendrën historike të Ostunit; pika shitje të ngritura nga fermat që tregtojnë direkt duke shkurtuar zinxhirin e furnizimit.

Ky model turizmi filloi rreth 20 vjet më parë dhe ka siguruar një vlerë të shtuar në prodhimin e ullirit (Vaji ullirit **Collina di Brindisi PDO** nxjerrë nga ullinjtë monumentale) dhe peisazhin historik rural.

Infrastruktura e parë e *Via Traiana* ndodhi në vitin 2008 me ngritjen e 34 zonave të pushimit dhe vendosjen e sinjalistikës në shërbim të shtegut të Adriatikut për biçikleta (no. 6 of Bicitalia). Zonat e pushimit kanë

përmirësuar shtegun *Via Traiana* në vende ku më parë ishin landfillle ku hidheshin mbeturina. Është rigjeneruar edhe stacioni i vjetër i trenit, që nuk përdoret më, që kryqëzohet me *via Traiana*. Stacioni *Fontevecchia* rrethuar nga ullishte shekullore ka një Qendër për Vizitorët në Parkun Natyral Rajonal të Dunave Bregdetare me shërbim qiradhënie biçikletash dhe aktivitete marshimi.

Një shtëpi e mëparshme udhëtarësh ANAS, gjatë shtegut *Traiana* është rindërtuar dhe transformuar në një objekt miqësor për çiklizëm (**Albergabici**) ku ka një punishte të pajisur me biçikleta, një Qendër për Vizitorët me ekskursione dhe shërbime guide për zonat rurale, qeradhënie biçikletash dhe akomodim për çiklistët dhe pelegrinët me 18 shtretër, shërbim lavanderie, mëngjes etj.

Objektet e shumta të vogla të akomodimit (me 1,600 shtretër të rinj), krijuar me nxitje të LAG, jo vetëm që kanë kontribuar për riparimin e ndërtesave me vlera historike dhe arkeologjike të shpërndara gjerësisht në rrafshinën e ullishteve (*trulli, lamie* dhe shtëpi ferme), por kanë qenë të dobishme për konsolidimin e ofertave turistike, që kanë të bëjnë me turizmin slow, ushqimin dhe verën dhe që ndikojnë shumë në industrinë e turizmit.

Mbrojtja e relievit rural në rrafshinën e ullinjve shekullorë përgjatë shtegut *via Traiana* është bërë nëpërmjet krijimit të përfitimeve të reja të siguruara nga përmirësimi i prodhimeve bujqësore dhe ofrimi i shërbimeve inovative turistike që lidhen me mbrojtjen e ullishteve monumentale.

Kjo e fundit është e njohur në Rajonin e Puglias me **Ligjin Rajonal 14/2007 mbi mbrojtjen dhe përmirësimin e rrafshinës së pemëve monumentale të ullirit të Apulias**, dhe aktualisht nëpërmjet një aplikimi është e mundur të identifikohet referenca gjeografike e secilës pemë ulliri me një kartë përshkruese dhe fotografi.

Për më tepër, rrafshinat Ostuni dhe Carovigno të ullishteve monumentale janë njohur dhe listuar në **Regjistrin Kombëtar të Terreneve Historike Rurale të Ministrisë së Bujqësisë**.

Në vitin 2007, projekti për bashkëpunimin trans-nacional LeaderMed ndërmjet Alto Salento LAG dhe rajonit Ibled në Siri, mbështetur nga rajoni Puglia dhe Instituti Agronomik Mesdhetar i Barit, mundësoi krijimin e **Rrugës Monumentale të Ullishteve** duke sjellë së bashku në një proces pjesëmarrës përpunuesit dhe kultivuesit e ullirit, pikat e shitjes së vajit të ullirit, fermat familjare me plantacione të vjetra ulliri dhe mullinjtë nëntokësorë mesjetarë të vajit.

I fundit për tu përmendur është **Bio-shtegu i Via Traiana**, një projekt që integron modele të bujqësisë së qendrueshme në rajon me vlera të mëdha mjedisore dhe kulturore. Udhë shket përgjatë shtegut të vjetër *via Traiana* në rrafshinën e ullishteve të vjetra dhe vijon nëpër asetet me interes arkeologjik dhe historik-kulturor, fermat, sipërmarrjet e agroturizmit, të cilat kryejnë aktivitetet e tyre në një terren interesant me atraksion të madh turistik.

Turizmi Slow dhe shtigjet distancë-gjata kombëtare dhe Europiane

Turizmi *slow* është rritur shumë vitet e fundit, me një rritje të konsiderueshme të numrit të këmbësorëve dhe çiklistëve të cilët ndjekin shtigje të njohura në nivel ndërkombëtar. Rrjeti i shtigjeve është pjesë e strategjive të BE që synon përmirësimin e vlerave të zonave marginale të brendshme, të paprekura nga turizmi masiv dhe të cilat shpesh ruajnë autencitetin e tyre. Këto janë territore ku është ende e mundur të gjenden elementë me vlera natyrore dhe kulturore, me një tip tradicional bujqësie dhe kulinari me rrënjë në traditë dhe mbështetur në përdorimin e lëndëve të para të vendit.

Kjo paraqet një mundësi të madhe për promovimin e një forme të turizmit të qendrueshëm, e cila është në përputhje me komunitetet lokale, vlerëson zonat historike dhe të natyrës që duhen eksploruar dhe zbuluar në kohë, preferon eksperiencat që mundësojnë kontaktin direkt me mjedisin, zakonet dhe ushqimin e komuniteteve të vendit.

Megjithatë është e nevojshme pajisja e përshtatshme për akomodimin e këmbësorëve dhe çiklistëve, duke iu ofruar atyre shërbimet e duhura, duke filluar nga akomodimi i përshtatshëm, dhënia me qera e biçikletave dhe riparimi i tyre, deri në ofrimin e informacionit për njohjen e zonës përreth, përfshi shtigjet ekzistuese dhe

shërbimet e disponueshme gjatë tyre. Gjithashtu duhen njohuri të gjuhës dhe harta të vlefshme e materiale informimi në gjuhë të ndryshme. Është esenciale të kualifikohen operatorët si për shërbimet e ofruara në objektet e akomodimit edhe ato që ofrohen jashtë këtyre strukturave përreth, të cilat ofrojnë informacion të dobishëm mbi asetet mjedisore dhe kulturore, shërbimet e ofruara nga entitete publike (muze, parqe, zona arkeologjike, qendra vizitorësh) dhe persona privatë (akomodim, katering, aktivitete të kohës së lirë, vizita në fabrika vaji, ullishte, testime etj.).

Territori i mbuluar nga zonat e kultivimit të ullirit e targetuar në këtë projekt përshkohet nga rrjeti i shtigjeve distancë-gjatë kombëtare dhe ndërkombëtare (shtigje këmbësorësh dhe biçiklete):

- **Francigena në Jug** kalon përmes Venaftro me një ndalesë në udhën për në San Vittore. Shtegu fillon nga kufiri me Campanian, në kryqëzimin *Tre Torri*, rrëzohet poshtë drejt **Rrafshinës së Ullinjve Venaftro** dhe më pas ngjitet drejt fshatrave mesjetarë të Santa Maria Oliveto dhe Roccaravindola Alta, me pamje piktoreske të rrafshinës dhe ullishteve ekstensive në këmbët e Matese, për të arritur më në fund në Isernia.
- **Saint Tomotheus** I gjatë 188 km fillon nga Venaftro në Termoli me 18 ndalesa. I kalueshëm në këmbë, me biçikletë dhe kalë ai përshkon fshatrat më të bukur të Molises. Është një shteg i krijuar për të konkurruar me shtigjet më të famshme spirituale, të tilla si *Via Francigena* dhe *Way to Santiago*.
- **Dinarica** 2,000 km e gjatë që kalon në 8 vende, përcaktuar nga National Geographic Traveller si shtegu më i mirë në botë për këmbësorë. Është një udhëtim kulturor përmes Alpeve Dinarike dhe tetë vendeve, përkatësisht Slloveni, Kroaci, Bosnje-Hercegovinë, Mal i Zi, Kosovë, Serbi, Shqipëri dhe Maqedoni. Ndonëse të ndryshëm nga njeri tjetri, të gjithë këto vende kanë relief spektakolar. *Via Dinarica* është bërë e shfrytëzueshme që prej vitit 2010 me qëllim mbështetjen e komuniteteve të vogla malore nëpërmjet turizmit. **Në Mal të Zi** është i mundur rafting në lumin Tara që përshkon kanionin më të thellë në Europë në 1,300 m lartësi dhe me pamje që të lenë pa frymë. Duke mbërritur në **Shqipëri**, në qytetin e Shkodrës, arrini në fshatin e vogël Theth: Tur këmbësor prej 7 orë duke u ngjitur në 2,700 m lartësi dhe që të udhëheq në drejtim të Parkut Kombëtar të Luginës së Valbonës. Përpara se të mbërrish në kufirin me Kosovën, mund të qendrosh në familjet mikpritëse në komunitetin malor të Dobërdolit.
- **Bicitalia Francigena (itinerari BI3)** me gjatësi 150 km që fillon në këmbët e malit Azzone, në kufi të tre rajoneve: Abruzzo, Latium dhe Molise dhe vijon përgjatë lumit Volturno deri në Capua, duke përshkuar Cerro al Volturno dhe **Venaftro** në shtigje të shtruara e të pashtuara që mund të përshkohen me këmbë, me biçikletë.
- **Eurovelo 8 në Mal të Zi** kalon përgjatë dhe pranë vijës bregdetare për 160 km përmes parqeve natyrore dhe relieveve të mahnitshëm. Me të mbërritur në Mal të Zi mund të vizitoni Gjirin e Kotorit, i cili është një zonë e trashëgimisë botërore. Nga qyteti i Herceg Novit (të quajtur Castelnuovo gjatë dominimit Venecian) mund të shkoni në plazhe të shumtë të rrethuar me vegjetacion dhe të vizitoni disa manastirë katolikë dhe ortodoksë që mbrohen nga UNESCO. Eurovelo 8 vijon përgjatë gjithë bregut të detit, përshkon **Tivarin**, një bastion i lashtë Venecian në të cilin mund të admironi pjesë të fortifikimeve të kohës. Në Ulqin (135 km) ktheni drejt kufirit me Shqipërinë.
- **Eurovelo 8 në Shqipëri** është 355 km e gjatë. Hyni në vend nëpërmjet Shkodrës, kryeqytetit të lashtë të Ilirëve pranë liqenit. Pas fushave që shtrihen në gjatësi, duke kaluar përmes arave të kultivuara dhe fshatrave të vegjël, mbërrini në Tiranë ku rruga fillon të ngjitet për në provincën e Elbasanit, në brendësi të Shqipërisë malore, në rrugë dredha-dredha, pa përshkuar qytete të mëdha: mënyra më e mirë për të provuar mikpritjen që karakterizon komunitetet lokale.

KUADRI LIGJOR

Bazuar në nevojën për të shpërndarë sa më shpejt të jetë e mundur eksperiencën e zhvillimit të turizmit nga zonat më të avancuara, si Molize dhe Apulia, studimi i paraqitur thekson nevojën për kuadër ligjor të veçantë në Shqipëri dhe në Mal të Zi për të zbatuar në kushtet e tyre specifike aktet ligjore të mëposhtme:

Ligji Rajonal n. 14 datë 4 Qershor 2007 mbi mbrojtjen dhe përmirësimin e pemëve monumentale të ullirit në rrafshinën e Apulias

http://www.sit.puglia.it/portal/portale_rete_natura_2000/Documenti/Ulivi%20monumentali

Ky është një nga ligjet e para Europiane për mbrojtjen e ullishteve të vjetra, duke njohur rëndësinë e tyre si kulturë bujqësore por gjithashtu si një pasuri kulturore me interes. Ka të bëjë me sa vijon:

- Pemët e ullirit njihen për zotërimin e një sërë funksionesh (prodhimtarie, ekologjike, hidrogeologjike, kulturore dhe panoramike);
- është dhënë përcaktimi për "Ullinjtë Monumentalë" (madhësia ≥ 100 cm vlerë historike dhe antropologjike, formë skulpturale e trungut, afërsi me trashëgiminë kulturore) ose "Ullishte Monumentale" (60% pemë monumentale);
- pemët monumentale duhen regjistruar;
- "Vaji ullirit ekstra i virgjër nga pemët e vjetra të ullirit të Apulias" njihet si PDO dhe PGI;
- terrenet e kultivimit të ullirit duhen mirëmbajtur dhe përmirësuar për turizmin rekreativ, dhe duhet tu jepet prioritet për fondet e nevojshme për zbatimin e Planit të Zhvillimit Rural Rajonal;
- do të krijohet një Komitet Teknik për mbrojtjen e ullinjve monumentale.

Sipas aktit L.R. no. 14/2007, është krijuar një aplikim special. "AppOLEA" është një aplikacion rajonal që mundëson kryerjen e një sensusi për ullinjtë monumentale në pronësi të individit. Rajoni Apulia do të mbrojë dhe përmirësojë ullinjtë monumentale edhe kur ato janë të izoluara, sa i takon funksioneve të tyre prodhuese, ekologjike dhe hidrogeologjike, dhe gjithashtu pasi ato përfaqësojnë një karakteristikë të dallueshme të historisë, kulturës dhe relievit të rajonit.

Ligji Rajonal no.30 i 2008 mbi Parkun Historik Bujqësor të Ullirit në Venafrò:

<http://www.regione.molise.it/web/crm/lr.nsf/0/389F0F94A956F4FCC1257508003EB308>

Parku Bujqësor Historik i Ullirit në Venafrò u krijua me Ligjin Rajonal no.30 të 2008 të formuluar nga Rajoni Molise. Zona e Parkut përfshin shumicën e ullishteve të vjetra, vlerat botanike, natyrore dhe historike të të cilave dhe trashëgimia gjenetike do të mbrohet nga Rajoni Molise.

Observatori Kombëtar i Relievit Rural (ONPR), Praktikat Bujqësore dhe Njohuritë Tradicionale vendosen me Dekretin no. 17070, 19 Nëntor 2012 të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Politikave Pyjore

<https://www.politicheagricole.it/flex/cm/pages/ServeBLOB.php/L/IT/IDPagina/5832>

Misioni i ONPR është kontrolli i terrenit, mbrojtja dhe përhapja e praktikave bujqësore dhe njohurive tradicionale. Këto sisteme komplekse bazohen në teknika të ndryshme indigjene dhe gjithashtu njohuritë lokale të zhvilluara nga qytetërime rurale që kanë kontribuar shumë në formimin dhe mirëmbajtjen e relievit tradicional. Studime dhe kërkime janë promovuar për të eksploruar vlerat që lidhen me relievin rural, mbrojtjen e tij, menaxhimin dhe planifikimin, gjithashtu me synimin për ruajtjen e diversitetit të tyre bio-kulturor.

Nga 1 Janar 2020, turizmi i ullirit është rregulluar me ligj, në sajë të një amendimi të aprovuar në 2020 të Ligjit të Financës, i cili e vendos turizmin e ullirit dhe aktivitetet e lidhura me të në të njëjtën pozicion me turizmin e verës. Aktivitetet që lidhen me turizmin e ullirit përfshijnë të mësuarit mbi vajin e ullirit në vendin ku është prodhuar, nëpërmjet vizitave në zonat e kultivimit dhe të prodhimit ose nëpërmjet paraqitjes së mjeteve të përdorura për kultivimin, testimin dhe marketingun e vajit të ullirit të prodhuar në fermë, i shoqëruar gjithashtu me ushqime të tjera, dhe iniciativave edukuese dhe çlodhëse në zonat e kultivimit dhe prodhimit.

5. Hartat komunitare të ullahteve monumentale

Zonat gjeografike Mesdhetare që karakterizohen nga prania e ullinjve të vjetër përfaqësojnë një sistem territorial kompleks ku historia, natyra dhe bujqësia janë ndërthurur në mijëvjeçarë.

Sot këto kontekste jo vetëm që janë të lidhura ngushtë me praktikën bujqësore, por përfaqësojnë një nga terrenet më të vjetër “kultivues” në Mesdhe. Vlera e vërtetë e këtyre terreneve nuk është e lidhur ekskluzivisht me prodhimin e ullirit, por gjithashtu të joshjes, konkurrencës rajonale, dhe atraksioneve turistike që shprehin. Në tregun e avancuar të turizmit i cili dominohet nga kërkesa për “eksperiencë” dhe autenticitet, potenciali i terrenit dhe pasuria historike e kulturore e ullishteve monumentale, nëse menaxhohet në mënyrë efektive dhe optimale, i ofron ekonomisë së këtyre zonave bujqësore shanse interesante për ta pozicionuar veten në një treg të ri turizmi dhe të kontrobuojnë për tu kthyer kultivuesve të ullirit të ardhura të kënaqshme për të kompensuar në mënyrë më të përshtatshme punën e tyre të përditshme si mirëmbajtës të terrenit. Zbulimi i pasurisë së trashëgimisë kulturore nëpërmjet perceptimit të banorëve të terreneve historike të ullinjve është qëllimi specifik i Hartave Komunitare që janë zhvilluar gjatë “WP T2 – planifikimi vendor për mbrojtjen e mjedisit dhe turizmit të qëndrueshëm”, në kuadrin e projektit “Cross Border OL”. Metodologjia eko-muzeum e përdorur tradicionalisht si një instrument efektiv për vlerësimin – së pari dhe kryesisht nga banorët – e pasurisë së secilit vend, forcon ndërgjegjësimin e vendasve mbi atë çka zotëron çdo komunitet, në projektin “Cross Border OL”, hartat komunitare janë interpretuar si një ushtrim për nxjerrjen në dritë të trashëgimisë lokale nëpërmjet pjesëmarrjes së komunitetit.

Në sajë të metodologjisë së zhvilluar dhe zbatuar në projekt, çdo zonë pilot ka hartuar një “inventar” të trashëgimisë territoriale vendore, të prekshme dhe jo të prekshme, duke përshkruar artistikisht një vizatim të terrenit të ullinjve të vjetër dhe duke nxjerrë në pah elementët e prekshëm dhe jo të prekshëm të trashëgimisë që palët e përfshira i kanë perceptuar si më efektivet për paraqitjen e identitetit të zonave.

Rezultati i projektit konsiston në zhvillimin e 6 hartave komunitare që i referohen zonave shqiptare Marikaj, Ndroq dhe Prezë, zonave të kultivimit të ullirit të Tivarit dhe Ulqinit në Mal të Zi dhe zonës së Parkut Rajonal të Ullirit në Venafo, Itali.

Ndonëse të ndryshme në stil dhe teknikën e vizatimit, Hartat Komunitare portretizojnë 6 territore ku në matricat e përbashkëta dhe unike të ullishteve historike, shfaqen memorje individuale dhe kolektive që të sjellin ndërmend mjedisë, marrdhënie, ngjarje reale dhe imagjinare që ngrihen mbi vlerat njerëzore se sa mbi ato gjeografike.

Të gjashtë zonat e përshkruara në Hartat Komunitare të projektit sfumojnë karakteristikat territoriale gjeografike në favor të zmadhimit të evidencës së atyre kulturore dhe sociale e historike të popujve që i banojnë këto zona, të ndërveprimit të lashtë emocional ndërmjet banorëve dhe mjedisit rrethues. Të gjitha gjurmët, të prekshme (p.sh. ndryshimet e terrenit, arkitektura historike ose tipet e ndërtimeve) dhe jo të prekshme (të tilla si legjendat dhe karakteristikat linguistike) përfaqësojnë atë që është përcaktuar si trashëgimi kulturore e vendit, jo domosdoshmërisht si ekselencë, por gjithashtu dhe mbi të gjitha si jeta e përditshme.

Në kuadrin e objektivave të përgjithshme, të gjashta Hartat Komunitare të krijuara nga projekti “Cross Border OL” janë efektive dhe instrumente origjinale për promovimin e turizmit në territoret e ullishteve historike. Hartat ofrojnë përveç imazheve, përshkrime dhe informacion mbi çështje me interes për vizitorët, duke u fokusuar në elementët që mbështesin mënyrën më të përshtatshme për të shijuar turizmin në zonat rurale, që është, pa dyshim, turizmi eksperimental.

Kjo formë turizmi ushqen një lëvizje globale në rritje duke përfshirë vizitorët gjatë udhëtimit në një sërë aktivitete të paharrueshme me përmbajtje të lartë emocionale, por me vëmendje të veçantë ndaj ndikimit në mjedis dhe me respekt për natyrën dhe komunitetin lokal. Këto aktivitete eksperimentale janë

karakteristike për stimulim në të gjitha drejtimet dhe krijojnë lidhje në nivel fizik, emocional, shpirtëror, social dhe intelektual. Gjatë këtyre eksperiencave, turistët ndërveprojnë me njerëzit (komunitetin lokal), historinë dhe traditën e vendit. Si konkluzion, të gjashtë Hartat Komunitare të projektit “Cross Border OL” pasurojnë mënyrën e komunikimit dhe promovimit të ofertave të turizmit eksperimental ndër-kufitar që këto territore i propozojnë tregut, duke kontribuar për rrjedhojë për arritjen e 3 kërkesave bazë të eksperiencave:

- Ji autentik duke i ofruar turistëve eksperiencë të vërteta dhe të singerta,
- Ji i ndjeshëm duke i bërë njerëzit të provojnë dhe ndjejnë destinacionet **me të** pesë shqisat
- Ji gjithëpërfshirës duke induktuar vizitorët të zhytin vetveten tërësisht në vendin dhe kulturën lokale dhe duke stimuluar dëshirën e tyre për tu shkrirë në të.

6. Harta e aktorëve të përfshirë

Në **Shqipëri** në lidhje me menaxhimin e ullishteve të vjetra janë identifikuar 63 aktorë të grupuar në 4 kategori si: kultivues ulliri, përpunues, organizatat artizanale dhe entitete të tjera përfshi OJQ-të, përfaqësuesit e shoqatave të kultivuesve të ullirit, agjensitë turistike dhe guidat individuale, institucionat shtetërore autoritetet e qeverive vendore që mbështesin zhvillimin e sektorit të ullirit, ose mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të prekshme dhe jo të prekshme. Të gjithë aktorët janë të lidhur specifikisht me të tre zonat e përzgjedhura: Marikaj, Prezë dhe Ndroq.

Ndër aktorët e ndryshëm, ata që merren veçanërisht me turizmin në Shqipëri dhe përfaqësojnë interlokutorë të rëndësishëm për lançimin e shërbimeve të reja të turizmit, ose konsolidimin e atyre ekzistuese, që lidhen me përmirësimin e ullishteve të vjetra janë:

- Visit-Tirana.com, një portal që ofron informacion mbi vendet me interes turistik, atraksione të ndryshme, përfshi ullishtet, objektet akomoduese dhe shërbimet për vizitorët që kanë zgjedhur të qendrojnë në Tiranë dhe zonat përreth;
- Agritour Albania, agjensi udhëtimi që operon në fushën e agroturizmit në Shqipëri. Ofron paketa ditore për individë, familje dhe grupe që dëshirojnë eksperiencë alternative dhe vende pak të njohura natyrore dhe kulturore. Ofron programe shetitje dhe testime produkteve organike me qëllim përhapjen e njohurive dhe stilit të jetës të familjeve shqiptare, duke favorizuar marrdhëniet direkte me fermerët ose organizatorët e tureve për të mësuar rreth kuzhinës tradicionale, vjeljes së ullinjve dhe rrushit, prodhimit artizanal të mjaltit, verës, vajit të ullirit etj. Agjencia mund të krijojë edhe paketa speciale sipas nevojave specifike të individëve ose agjensive të udhëtimit.
- Discover Albania, agjensi udhëtimesh që operon në fushën e promovimit dhe organizimit të vizitave në gjithë Shqipërinë. Ajo propozon vizita ditore në vende turistike në rajonin e Tiranës kështu ata mund të përfshijnë propozime guidash turistike në zonat e përzgjedhura të projektit. Disa guida në fakt njohin vendet dhe itineraret turistike të zonës dhe janë të gatshëm të promovojnë turizmin që lidhet me ullishtet shekullore.
- Shoqata Shqiptare e Ullirit (AOA) promovon aktivitete të reja në fushën e prodhimit dhe marketingut të vajit të ullirit. Ajo prodhon Gazetën tremujore Agrobiznesi me artikuj mbi performancën e industrisë, tregëtinë dhe informacione mbi teknologjitë.
- Shoqata Shqiptare e Turizmit (ATA) është një OJQ që vepron si organizatë ombrellë për të përfaqësuar interesat e agjensive turistike, guidave dhe operatorëve të organizimit të tureve. ATA ka një rrjet të gjerë partnerësh operatorë agjensi turistike.
- Familja Subashi në Marikaj është shumë aktive në sektorin e ullirit dhe vajit dhe në promovimin eno-gastronomik dhe kulturor të rajonit. Ajo është pronare e ullishtes “Skënderbej” me 1200 rrënjë ullinj 500 vjeçarë të varietetit Ulliri i Bardhë i Tiranës. Kjo familje gjithashtu prodhon sapunë aromatikë me bazë vaj ulliri, erëza të ndryshme të paketuara, çaj lokal, suvenire me dru ulliri dhe disa lloje vaji ulliri të aromatizuar me erëza.

Në **Venafro** aktorët e angazhuar në menaxhimin e ullishteve dhe ofrimit të shërbimeve të turizmit që lidhet me promovimin e ullishteve të vjetra, janë të mëposhtmit:

Autoriteti i Parkut Rajonal Bujqësor Historik të Ullirit Venafro, krijuar me Ligjin Rajonal no.30 të vitit 2008 për mbrojtjen e ullishteve në Venafro si një element i identitetit të terrenit historik, siguron i përdorimit të tokës për përdorim bujqësor, edukimit shkencor, kulturor, social dhe qëllimeve rekreative, promovimit të vajit të prodhuar në zonë në bashkëpunim me fermerët, individualë apo në shoqata, promovimit të identitetit historik të Venafros si karakteristikë dhe element prioritar i parkut, nëpërmjet iniciativave, marrëveshjeve dhe programeve rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare me institucione, administrata, fondacione, shoqata, cooperativa, dhe trupa të tjera religjioze etj.

- Trancesco Tomasso, organizues i eventeve dhe eksperiencave të turizmit të vajit të ullirit
- Guglielmo Ruggiero, guidë për ekskursione në natyrë në Campobasso
- Parku da Viaggi dell'Origano, agjensi në Bonefro (CB)
- Shoqata ME.MO Cantieri Culturali (vendet kulturore) së cilës Mibact (Ministria e Kulturës për pasuritë Kulturore dhe Mjedisore) i ka besuar shërbimet e guidës për monumentet kryesore në Venafro
- Info point Pallati i Lirisë
- Koperativa Colonia Julia Venafrana, prodhuese e vajit të ullirit me etiketën e parkut "Terre degli olivi di Orazio" nga ullinjtë e Parkut Rajonal Venafro. Kompania njihet si Presidiumi Sloëfood. Së fundmi cooperativa ka zvogëluar numrin e anëtarëve dhe është ndarë.
- Ferma Luca Del Prete fermë organike e vajit ekstra të virgjër organik PDO Molise, dhe vajit Colonia Julia në format të ri.

Në **Mal të Zi**, aktorët e angazhuar në menaxhimin e ullishteve të vjetra dhe shërbimeve të turizmit janë si më poshtë:

- Komunitetet Lokale
- Fermerët e ullirit/ pronarët e ullishteve dhe përpunuesit
- Shoqatat e fermerëve të ullirit, shoqata e vajit të ullirit të Malit të Zi
- Shoqata e biznesit Ulqin
- Komunitetet lokale të qytetit të vjetër dhe organizatat e turizmit Ulqin
- Agjencitë turistike, shoqatat e ekskursioneve dhe guidat turistike
- Restorantet, hotelet dhe B&B, artizanët dhe operatorët e plazhit
- Organizata Kombëtare e Turizmit e Malit të Zi
- Qendra e Kulturës
- Fakulteti i Bioteknologjisë
- Shkolla e Mesme Bujqësore
- Bashkitë Tivar dhe Ulqin
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Ministria e Turizmit dhe Zhvillimit të Qendrueshëm
- Sipërmarrja Publike "Qendra e Kulturës" Ulqin
- Museu Ulqin
- Ndërmarrja publike për menaxhimin e bregdetit Mal I Zi
- Agjensia e Mbrojtjes së Mjedisit e Malit të Zi
- OJQ-të MogUL dhe Green Home.

7. Plani për strategjinë e zhvillimit të qendrueshëm të turizmit

Ullishtet monumentale në zonat e studimit në Shqipëri, Mal të Zi dhe Rajonin e Molizes përfaqësojnë një element identifikimi të këtyre territoreve, i lidhur pazgjidhmërisht me historinë dhe kulturën e rajonit të Mesdheut dhe relievit të tij, traditës kulinare dhe stilit të jetës.

Përveç rolit të tyre të rëndësishëm ekologjik, zonat me ullishte kanë paraqitur gjithmonë një element thelbësor për ekonominë e këtyre territoreve, si në vlerë absolute ashtu edhe në terma të punësimit.

Aktualisht, mosha e vjetër e punëtorëve të bujqësisë së bashku me nivelin e ulët të gjenerimit të të ardhurave, fragmentimi i tokës dhe tendenca e ulët për inovacion, janë kushtet e identifikuar në të gjitha zonat e përfshira në projekt ashtu si edhe në zona të tjera marginale të rajonit të Mesdheut.

